



GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Buletini Informativ

Korrik – Dhjetor 2024



Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS	2
VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....	5
AKTGJYKIME	10
GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME	38

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

* Gjykata aktualisht përbëhet nga shtatë (7) gjyqtarë.






Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 korrik – 31 dhjetor 2024, Gjykata ka pranuar 135 kërkesa të reja, ndërsa ka pasur në punë gjithsej 382 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 102 kërkesa janë zgjidhur ose 26.63% e të gjitha rasteve në dispozicion.

Gjatë kësaj periudhe, 141 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

*Dinamika e kërkesave të pranuar sipas muajve
(1 korrik – 31 dhjetor 2024)*



Në vijim janë paraqitur njëzet e pesë (25) aktgjykimet që Gjykata i nxori gjatë periudhës gjashtëmuajore, 1 korrik – 31 dhjetor 2024:

- Aktgjykim në rastin KO157/23, parashtruar nga: Vlora Dumoshi dhe 11 deputetë tjerë. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-583 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 13 korrikut 2023, për shkarkimin e anëtares së Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.
- Aktgjykim në rastin KI154/23, parashtruar nga: Afrim Tafarshiku. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës [AC. Nr. 8304/2021], të 20 shkurtit 2023.
- Aktgjykim në rastin KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, parashtruar nga: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4, paragrafit 4 të nenit 432, dhe paragrafit 2 të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr.08/L-032.

- Aktgjykim në rastin KO232/23 dhe KO233/23, parashtruar nga: Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë; dhe Besian Mustafa dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.
- Aktgjykim në rastin KO46/23, parashtruar nga: Abelard Tahiri dhe 9 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.
- Aktgjykim në rastin KI199/22, parashtruar nga: P.T.P. “Arta XH”. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [E. Rev. br. 75/20/2021], të 20 gushtit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI172/23, parashtruar nga: Rejhane Ceka, Fiknete Ceka, Lejlane Ceka dhe Sara Ceka. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 216/2023], të 19 qershorit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 3023/2020], e 7 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës.
- Aktgjykim në rastin KI04/23, parashtruar nga: Avdyl Bajgora. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 43/2022], të 10 tetorit 2022.
- Aktgjykim në rastin KO158/23, parashtruar nga: Besnik Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të ardhurat Personale Vjetore.
- Aktgjykim në rastin KO248/23, parashtruar nga: Ferat Shala dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme.




- Aktgjykim në rastin KI272/23, parashtruar nga: Ali Tahiri. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AKPA.II.nr.163/23] të 1 nëntorit 2023, të Prokurorisë së Apelit.
- Aktgjykim në rastin KI23/24, parashtruar nga: Agim Zogaj. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit [AC-I-21-0836-A0001], të 26 tetorit 2023.
- Aktgjykim në rastin KI190/22, parashtruar nga: Ramiz Isaku. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-21-0642] të 31 gushtit 2022 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
- Aktgjykim në rastin KI103/24, parashtruar nga: Sylejman Zeneli. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev.nr.485/2022], të 5 janarit 2023.
- Aktgjykim në rastin KI177/22, parashtruar nga: Pashk Bibaj. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit [AC-II-21-0058], të 23 majit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI49/23, parashtruar nga: Shaban Dulahu dhe të tjerët. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ-UZVP.NR.109/2022], të 20 tetorit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI36/23, parashtruar nga: “DONA-IMPEX” sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [E. Rev. nr. 45/2021], të 10 nëntorit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI43/24, parashtruar nga: Merita Visoka, Eroll Visoka dhe Melinda Visoka. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 382/2023], të 17 tetorit 2023.
- Aktgjykim në rastin KI84/22, parashtruar nga: Slavica Đorđević. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 170/2021], të 19 tetorit 2021.
- Aktgjykim në rastin KI11/24, parashtruar nga: Zekë Jasiqi. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës [PN. nr. 1420/23], të 15 nëntorit 2023.
- Aktgjykim në rastin KI105/24, parashtruar nga: Imrije Kadriu. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës [Ac. nr. 2125/22], të 23 shkurtit 2024.
- Aktgjykim në rastin KI117/23, parashtruar nga: “Exclusive” sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [E. Rev. nr. 1/2023], të 17 janarit 2023.
- Aktgjykim në rastin KI118/23, parashtruar nga: Shehide Muhadri. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës [Ac.nr.530/2016], të 30 marsit 2023.
- Aktgjykim në rastin KO15/24, parashtruar nga: Institucioni i Avokatit të Popullit. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 28 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
- Aktgjykim në rastin KO283/23, parashtruar nga: Abelard Tahiri dhe 9 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-668 të 15 dhjetorit 2023, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkarkimin e z. Agron Beka nga pozita e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 108 kërkesa ose 80% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;
- 27 kërkesa ose 20% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e autoriteteve të tjera publike;

*Shkelësit e supozuar të të drejtave
(1 korrik – 31 dhjetor 2024)*




Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 korrik – 31 dhjetor 2024, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 15 seanca plenare dhe 122 kolegje shqyrtuese, në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime dhe vendime. Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 141 vendime. Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 25 Aktgjykime;
- 105 Aktvendime për papranueshmëri;
- 11 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër;

*Struktura e vendimeve të publikuara
(1 korrik – 31 dhjetor 2024)*




Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 80 kërkesa nga shqiptarët, ose 93%;
- 5 kërkesa nga komuniteti serb, ose 5,8%;
- 1 kërkesë nga komuniteti boshnjak, ose 1,2%;

*Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave
(1 korrik – 31 dhjetor 2024)*





12 korrik 2024



Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Selvete Gërxhaliu – Krasniqi dhe z. Jeton Bytyqi, qëndruan për vizitë pune në Këshillin Kushtetues të Republikës së Francës, me seli në Paris.

Gjatë vizitës në Këshillin Kushtetues francez, gjyqtarja Gërxhaliu – Krasniqi dhe gjyqtari Bytyqi fillimisht u pritën në takim nga Sekretari i përgjithshëm i këtij institucioni, z. Jean Maïa, i cili i informoi më për së afërmi me procedurat standarde të shqyrtimit të rasteve dhe kërkesave të parashtruara, me funksionimin e departamentit ligjor, si dhe për mënyrën e përgatitjes së draft-vendimeve para miratimit të tyre final.

Në vijim të vizitës, gjyqtarja Gërxhaliu – Krasniqi dhe gjyqtari Bytyqi u pritën në takim të veçantë nga Kryetari i Këshillit Kushtetues të Francës dhe ish-kryeministri francez, z. Laurent Fabius.

Në ditën e dytë të vizitës, gjyqtarët Gërxhaliu – Krasniqi dhe Bytyqi u takuan me dy anëtarët gjyqtarë të Këshillit Kushtetues të Francës, znj. Corinne Luquiens dhe znj. Véronique Malbec, ku temë diskutimi, ndër të tjera, ishin edhe çështjet e ndryshme kushtetuese të trajtuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe zbatimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vizita e gjyqtarëve Gërxhaliu – Krasniqi dhe Bytyqi është realizuar në vazhdimësi të bashkëpunimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me gjykatat franceze, përkatësisht, Këshillin Kushtetues, Këshillin Shtetëror dhe Gjykatën e Kasacionit të Francës.

18 korrik 2024

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Jonathan Hargreaves. Pasi që i shprehu

mirëseardhjen, kryetarja Caka – Nimani e njoftoi ambasadorin Hargreaves me punën e deritanishme të Gjykatës, me sfidat në punë dhe angazhimin për tejkalimin e tyre, si dhe për raportet e mira të bashkëpunimit me gjykatat homologe në rajon dhe më gjerë. Ajo shprehu falënderimin e saj për ndihmën e vazhdueshme që Qeveria britanike i ka ofruar Gjykatës Kushtetuese, por edhe institucioneve të tjera në vend, për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe infrastrukturore.

Ambasadori Hargreaves, pasi që falënderoi Kryetaren Caka – Nimani për pritjen, theksoi se misioni diplomatik i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë mbetet i përkushtuar për fuqizimin e sektorit të drejtësisë dhe mbrojtjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor në vend.



9 shtator 2024

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe gjyqtarja Remzije Istrefi – Peci, pritën në takim të përbashkët një delegacion zyrtar nga Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë.

Gjatë bashkëbisedimit me delegacionin e përbërë nga këshilltarë dhe hulumtues ligjor të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, kryetarja Caka – Nimani fillimisht i njoftoi ata me historikun e shtet-



ndërtimit dhe zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese në Kosovë, me themelimin e Gjykatës Kushtetuese dhe hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me ndihmën e ofruar nga donatorë të shumtë ndërkombëtarë në ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe profesionale të Gjykatës.

Në vazhdim, kryetarja Caka – Nimani diskutoi edhe për konsolidimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës ndër vite, rastet më me rëndësi të trajtuara, për



zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimet e Gjykatës, si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer me Komisionin e Venecias dhe gjykatat kushtetuese të shteteve tjera anëtare.

Ajo shprehu një falënderim të veçantë për Gjykatën Kushtetuese Federale të Gjermanisë, për ndihmën e ofruar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës që nga ditët e para të themelimit, duke veçuar përkrahjen e ofruar nga Qeveria gjermane për punëtoritë profesionale me gjyqësorin e rregullt, si dhe për mbështetjen e vazhdueshme në përpjekjet për anëtarësimin e Gjykatës në forumet profesionale ndërkombëtare.

Gjyqtarja Remzije Istrefi – Peci i njoftoi ndërkaq mysafirët gjermanë më për së afërmi me qasjen e qytetarëve në Gjykatë, për organizimin e ditëve të Gjykatës së hapur, si dhe për takimet dhe vizitat periodike që nxënësit, studentët dhe pjesëtarët e komunitetit juridik i realizojnë në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese.

18 shtator 2024



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim shefin e ri të Zyrës së BE-së dhe Përfaqësuesin e Posaçëm të BE-së në Kosovë, z. Aivo Orav.

Pasi që i uroi suksese në detyrën e re, kryetarja Caka – Nimani e njoftoi z. Orav me historikun e themelimit të Gjykatës Kushtetuese, që pasoi miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në vitin 2008, me vendimet më me rëndësi të Gjykatës ndër vite dhe me progresin e arritur në konsolidimin e praktikës gjyqësore.

Ajo shprehu një falënderim të veçantë për përkrahjen e vazhdueshme që institucionet evropiane dhe donatorët e tjerë ndërkombëtar i ka dhënë Gjykatës Kushtetuese në konsolidimin e kapaciteteve të saj profesionale dhe infrastrukturore.

Kryetarja Caka – Nimani në vazhdim vuri theksin edhe në rolin me rëndësi që Gjykata Kushtetuese vazhdon të ketë në proceset e zhvillimit demokratik të vendit, si dhe për zbatimin e praktikës gjyqësore të

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrjen e saj.

Ambasadori Orav konfirmoi nga ana e tij se, përkrahja për forcimin e sundimit të ligjit në vend dhe për një sistem gjyqësor të pavarur mbetet prioritet i institucioneve të BE-së.

20 shtator 2024



Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Remzije Istrefi – Peci, priti në takim një grup studentësh dhe hulumtuesish të rinj nga universitetet gjermane, të cilët po qëndrojnë në Prishtinë si pjesë e vizitës studimore: “E porsalindur – Të gjeturit e identitetit në Kosovë”.

Pasi që i falënderoi për vizitën, gjyqtarja Istrefi – Peci fillimisht i bëri një përshkrim të shkurtër historikut të vendit tonë, periudhës tranzitore deri në shpalljen e pavarësisë, miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe themelimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në vazhdim ajo i njoftoi studentët e rinj edhe me përbërjen e parë të gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës, me vendimet më me rëndësi të nxjerra nga kjo gjykatë ndër vite dhe për marrëdhëniet e mira të bashkëpunimit me gjykata homologe rajonale dhe evropiane, si dhe përpjekjet për anëtarësim në forumet e ndryshme ndërkombëtare profesionale.

Gjyqtarja Istrefi – Peci vuri theksin edhe në konsolidimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në zbatim të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të zbatimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çdo vendim të saj.

Studentët shprehën interesimin e tyre që të informohen më në detaje përkitazi me natyrën dhe numrin e rasteve të parashtruara, për rastet e parashtruara nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe për qasjen e qytetarëve në Gjykatë.

4 tetor 2024

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani qëndroi për vizitë zyrtare në Paris, me ftesë të Kryetarit të Këshillit Kushtetues të Francës, z. Laurent Fabius.

Kryetarja Caka – Nimani është ftuar për të marrë pjesë në ngjarjen tradicionale të organizuar nga Këshilli Kushtetues i Francës, “Nata e Ligjit”, në shënim të



përvjetorit të miratimit të Kushtetutës së Republikës së Francës.

“Nata e Ligjit”, e cila përveç se në Paris organizohet njëkohësisht edhe në territoret tjera franceze, mbledh çdo vit emrat më eminent nga gjykatat kushtetuese anembanë botës, institucionet e drejtësisë, asambletë parlamentare, odat e avokatëve, fakultetet juridike të universiteteve më prestigjioze dhe ekspertë ndërkombëtar të drejtësisë kushtetuese.

9 tetor 2024



Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në vijimësi të organizimit të punëtorive të përbashkëta profesionale, morën pjesë në punëtorinë e radhës të organizuar me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim juridik ndërkombëtar “IRZ”, e cila u mbajt në Selanik. Në konferencë morën pjesë znj. Gresa Caka-Nimani, kryetare e Gjykatës Kushtetuese, z. Fejzullah Rexhepi, kryetar i Gjykatës Supreme, z. Albert Zogaj, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ekspertët gjermanë të angazhuar nga Fondacioni “IRZ”, Prof. Dr. Michael Eichberger, ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, Dr. Matthias Hartwig, ish-bashkëpunëtor i lartë hulumtues në Institutin “Max Planck” për të Drejtën Publike dhe të Drejtën Ndërkombëtare Krahasuese në Gjermani, dhe gjyqtarët e këshilltarët nga të dy gjykatat vendore. Pjesë e konferencës përmes video-lidhjes ishte edhe Mohamed Montasser Abidi, kryesues i seksionit nga IRZ.

Temat që u trajtuan në këtë konferencë ishin: “E drejta e pronës”, “Gjykimi në mungesë” dhe “Qasja në drejtësi”, derisa panelistë ishin gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi, Jeton Bytyqi dhe Remzije Istrefi-Peci nga Gjykata Kushtetuese, dhe Rustem Thaqi, Afrim Shala e Zenel Leku nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Ekspertët gjermanë të angazhuar nga IRZ, në secilin panel të temave të trajtuara, sollën perspektivën dhe përvojën e gjyqësorit të rregullt dhe gjyqësisë kushtetuese gjermane.

18 tetor 2024

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së

Kosovës, z. Jeton Bytyqi, qëndroi për vizitë dyditore në Budva të Malit të Zi, më 17 dhe 18 tetor 2024, me ftesën për të marrë pjesë në Konferencën Rajonale për të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisin, organizuar nga Këshilli i Evropës në kuadër të Projektit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisin e Qëndrueshëm në Evropën Juglindore.

Konferenca mundësoi shkëmbimin e diskutimeve profesionale ndërmjet anëtarëve të gjyqësorit, prokurorive, shoqërisë civile dhe profesionistëve ligjorë nga shtetet e Evropës juglindore përkitazi me legjislacionin dhe praktikat gjyqësore të vendeve të ndryshme evropiane në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mjedisin.

Ndër të tjera, temë diskutimi në konferencë ishte edhe rritja e ndërgjegjësimit për ndërlidhjen thelbësore të të drejtave të njeriut dhe çështjes së mbrojtjes së mjedisit, duke identifikuar njëherësh sfidat dhe praktikat më të mira në këtë fushë.



24 tetor 2024

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ishte mikpritëse e Takimit të Dytë Vjetor të Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit, në cilësinë e njëres nga anëtarët themelues dhe me të drejta të barabarta të këtij forumi profesional ndërkombëtar të drejtësisë kushtetuese.

Përvjetori i parë i themelimit të Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit, u shënuar përmes disa aktiviteteve dhe Konferencës ndërkombëtare të organizuar në temën: “Evoluimet në drejtësinë kushtetuese bashkëkohore – shembulli i rajonit të Ballkanit”, që u mbajt në “Hotel Emerald” në Prishtinë.

Forumi i Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit, që u themelua më 27 tetor të vitit 2023, bashkon Gjykatat Kushtetuese të Kosovës, Shqipërisë, Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, dhe Turqisë, rreth vlerave të përbashkëta të demokracisë, sundimit të së drejtës dhe mbrojtjes të së drejtave të njeriut.

Ky forum profesional është themeluar me qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet gjykatave kushtetuese të rajonit dhe për të shërbyer si platformë diskutimi dhe shkëmbim përvojash mbi drejtësinë kushtetuese.

4 nëntor 2024



Kryetarja Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Podgoricë, me ftesën për të marrë pjesë në ceremoninë solemne që shënoi 60-vjetorin e themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi.

Gjatë qëndrimit në kryeqytetin malazez, kryetarja Caka – Nimani u takua me kryetaren e Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, znj. Snezhana Armenko, me të cilën diskutoi, ndër të tjera, mbi mundësitë e thellimit të bashkëpunimit të mëtejshëm midis dy gjykatave kushtetuese.

Në kuadër të ceremonisë solemne të organizuar në Podgoricë, kryetarja Caka – Nimani zhvilloi takime edhe me kryetar dhe ish-kryetar të gjykatave kushtetuese të vendeve të rajonit dhe vendeve të tjera evropiane.

4 dhjetor 2024



Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në krye me kryetaren e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Bërno të Republikës së Çekisë, më 3 dhe 4 dhjetor 2024.

Në ditën e parë të vizitës dyditore, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës Çeke, ku në takim u pritën nga kryetari, z. Josef Baxa dhe gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate.

Në kuadër të vizitës në Gjykatën Kushtetuese të Çekisë, u mbajt edhe një punëtori e përbashkët ndërmjet gjyqtarëve të dy gjykatave kushtetuese. Pas fjalëve hyrëse të kryetares Caka – Nimani dhe kryetarit Baxa, sesioni i parë i punëtorisë i vazhdoi punimet me prezantimin e gjyqtarit kushtetues çek, z. Tomáš Langášek, mbi aspektet kushtetuese të



përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve. Sesioni i dytë ndërkaq vazhdoi me prezantimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, z. Nexhmi Rexhepi, mbi çështjen e rishikimit kushtetues të reformave gjyqësore në vend.

Në ditën e dytë të vizitës, delegacioni i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës qëndroi për vizitë në Gjykatën Supreme të Republikës së Çekisë, ku në takim u pritën nga kryetari, z. Petr Angyalossy dhe gjyqtarët e tjerë. Numri i përgjithshëm i lëndëve të trajtuara, efikasiteti në vendimmarrje, si dhe raporti me gjykatën kushtetuese ishin vetëm disa ndër temat e trajtuara në takimin e përbashkët.

Vizita e delegacionit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Bërno u përmyll me takimin e përbashkët me gjyqtarët dhe kryetarin e Gjykatës Supreme Administrative të Republikës së Çekisë, z. Karel Šimka.

Vizita e delegacionit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Republikën Çeke u mundësua me përkrahjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, në kuadër të projektit “Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese në Zbatimin



dhe Përhapjen e Standardeve Evropiane të të Drejtave të Njeriut”.

18 dhjetor 2024



Me një ceremoni solemne të mbajtur në praninë e përfaqësuesve të lartë shtetëror, të korit diplomatik, organizatave vendore dhe të huaja, akademisë, shoqërisë civile dhe mediave, u bë pranim-dorëzimi solemn i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës ndërmjet Kryetares në largim, znj. Gresa Caka – Nimani dhe Kryetarit të zgjedhur, z. Nexhmi Rexhepi, mandati i të cilit fillon më 31 dhjetor 2024.

Në fjalën e saj, Kryetarja Caka – Nimani, pasi shtjelloi rëndësinë e Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e vlerave të demokracisë dhe peshën dhe simbolikën historike të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndër të tjera, theksoi që “mbrojtja e kësaj Kushtetute, nuk është thjeshtë një detyrë. Mbrojtja e kësaj Kushtetute, është akti më i lartë i patriotizmit të çdo qytetari të Republikës së Kosovës, të çdo shërbyesi publik, të çdo funksionari të lartë publik, e veçanërisht – i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.”

Kryetarja Caka-Nimani, falënderoi kolegët gjyqtarë, stafin e Gjykatës dhe të gjithë partnerët që kanë mbështetur Gjykatën në avancimin e saj ndër vite.

Në fjalimin e tij, Kryetari i zgjedhur i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhmi Rexhepi, pasi që falënderoi Kryetaren Gresa Caka – Nimani dhe gjyqtaren Selvete

Gërxhaliu – Krasniqi për shërbimin e devotshëm në mbrojtje të kushtetutshmërisë në vend me rastin e përfundimit të mandatit të tyre, ndër të tjera tha se, “pavarësia e pushtetit gjyqësor është gurthemel i demokracisë dhe është thelbësore për sendërtimin e parimit të ndarjes së pushteteve, për materializimin e sundimit të ligjit dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”. Ai tutje tha se, “ne të gjithë ndajmë besimin e patundur se, në një demokraci kushtetuese, asnjë pushtet nuk është suprem – vetëm Kushtetuta është supreme. Andaj, roli dhe detyra e Gjykatës Kushtetuese është të mbrojë dhe të ruaj supremacinë e Kushtetutës”. Në fund, ai falënderoi të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese “për besimin e dhënë për të qenë i pari në mesin e të barabartëve”.



Aktgjykim

KO157/23

Parashtrues

Vlora Dumoshi dhe 11 deputetë tjerë

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-583 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 13 korrikut 2023, për shkarkimin e anëtares së Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me shkarkimin e anëtares së Bordit të OSHP-së përmes Vendimit të kontestuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 13 korrikut 2023. Siç sqarohet në Aktgjykim, shkarkimit të anëtares së Bordit të OSHP-së, i kishte paraprirë Vendimi [PSH. 397/409/22] i Bordit të OSHP-së i 11 tetorit 2022, përmes të cilit ishte anuluar njoftimi i Autoritetit Kontraktues, përkatësisht Ministrisë së Shëndetësisë, për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizimi me Insulina Analoge nga Lista Esenciale Lot 1 dhe Lot 3”. Vendimi i lartcekur i Panelit Shqyrtues të OSHP-së ishte nxjerrë në mënyrë unanime, pas ankesës së dy (2) operatorëve ekonomikë dhe pas shqyrtimit të ekspertizës së ekspertit përkatës të prokurimit, duke saktësuar që anulohet Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe që çështja kthehet në rivlerësim. Vendimi i lartcekur i Panelit Shqyrtues të OSHP-së, me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, i është nënshtruar vlerësimi të gjykatave të rregullta, Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, respektivisht, të cilat kanë hedhur poshtë padinë, përkatësisht ankesën e Ministrisë së Shëndetësisë si të palejueshme. Si rrjedhojë, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte propozuar shkarkimin e kryesueses së Panelit Shqyrtues të OSHP-së që kishte nxjerrë vendimin e lartcekur, me arsyetimin e “shkeljes së etikës profesionale”. Ky propozim i Qeverisë, ishte shqyrtuar nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe

Transfere i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili, vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë mosmiratimin, përkatësisht refuzimin e propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e anëtares së Bordit të OSHP-së. Megjithatë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të 13 korrikut 2023, bazuar në propozimin e Qeverisë, përmes Vendimit të kontestuar, e shkarkoi anëtares e Bordit të OSHP-së.

Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kontestuan kushtetutshmërinë e këtij Vendimi të Kuvendit, duke pretenduar, ndër të tjera, që i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me kompetencën mbikëqyrëse të Kuvendit, sipas përcaktimeve të paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, në esencë, duke vënë theks, në (i) mungesën e bazës ligjore për shkarkimin përkatës; (ii) cenimin e pavarësisë funksionale të OSHP-së; (iii) ndërhyrjen në kompetencën e pushtetit gjyqësor për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimmarrjes së OSHP-së; dhe (iv) cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të anëtares së shkarkuar të OSHP-së. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës u kundërshtuan nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!

Në kontekst të çështjeve të mësipërme, Aktgjykimi fillimisht vë theks në faktin që, rrethanat dhe pretendimet e lartcekura, ndër tjerash, kanë ngritur çështje që ndërlidhen me: (i) kompetencën kushtetuese të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të mbikëqyru punën e institucioneve publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit si dhe kufizimet përkatëse në ushtrimin e këtij funksioni mbikëqyrës bazuar në Kushtetutë dhe ligjet e miratuara nga Kuvendi; (ii) pavarësinë e Agjencive të Pavarura të themeluara bazuar në nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, përfshirë statusin dhe pavarësinë funksionale e vendimmarrëse të OSHP-së sipas ligjeve të aplikueshme për prokurimin publik; dhe (iii) kompetencën e Kuvendit që në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës, të shkarkojë anëtarët e OSHP-së dhe kufizimet përkatëse bazuar në ligjet e aplikueshme për prokurimin publik.

Në kontekstin e parimeve që burojnë nga analiza e parimeve kushtetuese, Aktgjykimi fillimisht sqaron që Kuvendi e ushtron funksionin e tij bazuar, ndër të tjera, në nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, përfshirë kompetencën për të (i) miratuar ligje, rezoluta dhe akte tjera të përgjithshme; dhe (ii) për të mbikëqyru punën e Qeverisë dhe të institucioneve tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, që të dy këto kompetenca, përbëjnë thelbin e funksionit kushtetues të Kuvendit. Thënë këtë dhe bazuar, ndër të tjera, në nenet 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, në kontekst të kompetencës kushtetuese të mbikëqyrjes, Kuvendi është i kushtëzuar në ushtrimin e këtij funksioni në pajtueshmëri me (i) dispozitat kushtetuese, përfshirë ato të përcaktuara me nenet 3 [Barazi para Ligji], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës, respektivisht; dhe (ii) kufijtë dhe autorizimet e përcaktuara në ligjet e miratuara nga vet Kuvendi përkitazi me institucionet publike që i raportojnë/mbikëqyren nga Kuvendi. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, në kontekst të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës të Kuvendit lidhur me Agjencitë e Pavarura të themeluara bazuar në nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, në kuadër të të cilave hyn edhe OSHP-ja bazuar në karakteristikat e saj sipas ligjeve të aplikueshme të prokurimit publik, por edhe vet Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, rëndësi të veçantë ngërthejnë kufizimet mbikëqyrëse të Kuvendit bazuar në paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës dhe ligjet që ndërlidhen me prokurimin publik në Republikën e Kosovës, siç janë miratuar nga vet Kuvendi.

Aktgjykimi tutje sqaron se, përderisa bazuar në nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, Agjencitë e Pavarura themelohen me ligje të Kuvendit dhe të cilat, rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre, të njëjtat, bazuar në nenin e lartcekur të Kushtetutës, funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës dhe për më tepër, secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të tyre gjatë ushtrimit të kompetencave ligjore, në pajtim me ligj. Për më tepër, bazuar në dispozitat e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe ndryshimet dhe plotësimet respektive të këtij ligji, ndër tjerash, (i) OSHP është organ i pavarur shqyrtues dhe ushtron autoritetin, kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik; dhe (ii) asnjë person ose zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim politik ose ndikim të paligjshëm në OSHP apo ndaj ndonjë punonjësi të tij për ndonjë vendim. Më tej dhe sipas sqarimeve të dhëna, Ligji i lartcekur, përcakton raportin e OSHP-së me pushtetin gjyqësor dhe pushtetin legjislativ.

Në kontekst të të parit, ligji i aplikueshëm përcakton që ligjshmëria e vendimmarrjes së OSHP-së i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Ndërsa, në kontekst të të dytit, ligji i aplikueshëm përcakton raportin në mes të Kuvendit dhe OSHP-së, ndërlidhur me emërimin e anëtarëve të OSHP-së, detyrimet e raportimit dhe shkarkimin e anëtarëve të OSHP-së. Lidhur me këtë të fundit, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, marrë parasysh rëndësinë e pavarësisë funksionale të OSHP-së, ligjet e aplikueshme, ndër vite, kanë saktësuar që shkarkimi i anëtarëve të OSHP-së mund të bëhet vetëm pasi arsyet për shkarkim të vërtetohen përmes vendimmarrjes së gjykatave, ndërsa me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Prokurimin Publik të marsit të vitit 2016, përjashtimisht, është përcaktuar edhe mundësia që Qeveria t'i propozojë Kuvendit shkarkimin e kryetarit apo një anëtar të OSHP-së, "nëse ai/ajo vepron në kundërshtim me etikën profesionale që ndërlidhet me detyrat e tij/saj", bazë mbi të cilën ka rezultuar shkarkimi i anëtares së OSHP-së në rrethanat e rastit konkret.

Megjithatë, bazuar në sqarimet e dhëna në Aktgjykim, as Qeveria dhe as Kuvendi nuk kanë dhënë asnjë arsytim lidhur me cenimin e pretenduar të "etikës profesionale" të anëtares së OSHP-së, bazë kjo mbi të cilën ishte bërë propozimi dhe shkarkimi i saj. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere i Kuvendit i kishte rekomanduar këtij të fundit të mos e miratojë propozimin e Qeverisë për shkarkim. Për më tepër, Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, kishin hedhur si të palejuar padinë dhe ankesën e Ministrisë së Shëndetësisë për anulimin e Vendimit të OSHP-së. Në fakt, bazuar në rrethanat e rastit, rezulton që anëtarja e OSHP-së është shkarkuar për vendimmarrjen e saj lidhur me nxjerrjen e Vendimit të OSHP-së për anulimin dhe kthimin në rivlerësim të Njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë për anulimin e aktivitetit përkatës të prokurimit.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim dhe duke u mbështetur në garancitë kushtetuese dhe ligjore, si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, përfshirë në kontekst të shkarkimeve të anëtarëve të institucioneve/agjencive dhe/ose organeve të pavarura për shkak të vendimmarrjes, Gjykata thekson që pavarësia individuale dhe kolegjiale e anëtarëve të OSHP-së, nënkupton jo vetëm pavarësinë përballë ndikimeve të jashtme që mund të kenë anëtarët e OSHP-së, por edhe përballë ndikimeve nga organi, i cili i ka emëruar në pozitat përkatëse – në këtë rast, Kuvendi. Kjo pavarësi ngërthen qëllimin që anëtarët e organeve përkatëse të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre bazuar në autorizimet e dhëna përmes ligjeve të aplikueshme. Këto të fundit, për aq

sa është relevante në rrethanat e rastit, përcaktojnë saktë që (i) ligjshmëria e vendimmarrjes së OSHP-së, i nënshtrohet kontrollit gjyqësor; ndërsa (ii) anëtarët e OSHP-së, suspendohen dhe/ose largohen nga detyra, me rastin e ngritjes së një aktakuze apo një vendimi gjyqësor të formës së prerë, respektivisht. Mundësia e shkarkimit të një anëtari të OSHP-së për “etikë profesionale” nuk mund të përdoret në mënyrë formaliste për të arsyetuar shkarkimin e një anëtari të OSHP-së për vendimmarrje në raste konkrete, nëse nuk argumentohet në mënyrë bindëse shkelja e rregullave të “etikës profesionale”. Një precedent i tillë, bazuar në të cilin anëtarët e OSHP-së do të mund të shkarkoheshin për vendimmarrjen e tyre, do të cenonte thellë pavarësinë funksionale të OSHP-së dhe vet qëllimin e ekzistencës së saj, sipas përcaktimeve të ligjeve të aplikueshme.

Gjykata në Aktgjykimin e saj, përfundimisht ka ritheksuar që është i padiskutueshëm autorizimi i Kuvendit që bazuar në paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës të mbikëqyrë OSHP-në, por që në ushtrimin e këtij autorizimi, Kuvendi është i kufizuar në dispozitat kushtetuese, përfshirë pavarësinë e Agjencive të Pavarura sipas përcaktimeve të vet Kushtetutës dhe ligjeve të cilat vet Kuvendi i ka miratuar bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës. Aktgjykimi gjithashtu vë theks në vlerat e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, përfshirë parimet e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit dhe ndarjes e ndërveprimit të pushteteve, të cilat janë shtjelluar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, ndër vite, përfshirë në kontekst të rëndësisë së pavarësisë në vendimmarrje në ushtrimin e funksioneve publike sipas përcaktimeve të Kushtetutës dhe ligjeve të aplikueshme.

Bazuar si në shtjellimin e mësipërm, Gjykata vendosi, njëzëri, që (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, që Vendimi [nr.08-V-583] i 13 korrikut 2023 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për shkarkimin e anëtares së Bordit të OSHP-së, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe paragrafin 1 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.



Aktgjykim

KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23

Parashtrues

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4, paragrafit 4 të nenit 432, dhe paragrafit 2 të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr.08/L-032

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vendosur në rastet e bashkuara KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, të dorëzuara nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës bazuar në paragrafin 8 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem), paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) dhe paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr.08/L-032 (Kodi i Procedurës Penale).

Gjykata, njëzëri, vendosi që të deklarojë kërkesën e pranueshme dhe konstatoi (i) njëzëri, që formulimi “ose ndërprerjen” i paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (ii) njëzëri, që paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) të Kodit të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (iii) me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, që formulimi “përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë” i paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të



njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Aktgjykimi fillimisht sqaron që Gjykata Supreme si Gjykatë referuese, bazuar në katër (4) rastet në shqyrtim para saj dhe që ndërlidhen me paraqitjen e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj vendimeve respektive të Gjykatës së Apelit, përkatësisht (i) për ndërprerjen e paraburgimit; (ii) për kundërshtimin e provave dhe hedhje të aktakuzës; dhe (iii) për përfundimin e procedurës penale, ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të lartcekura të Kodit të Procedurës Penale, me dyshimin që të njëjtat nuk janë në përputhje me Kushtetutën, në thelb, sepse bazuar në këto dispozita, ushtrimi i mjetit të jashtëzakonshëm juridik nga Prokurori i Shtetit, do të mund të rezultonte në vendimmarrjen e Gjykatës Supreme në dëm të të pandehurit, në kundërshtim me parimin ne bis in idem. Gjykata Supreme, ndër tjerash, sqaron që, (i) kodet e mëhershme të procedurës penale, në kontekst të paraburgimit, kanë lejuar përdorimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë vetëm sa i përket caktimit dhe vazhdimin të paraburgimit, por jo edhe sa i përket ndërprerjes së paraburgimit, për më tepër që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur në dëm të të pandehurve, nëse është aprovuar si e bazuar, kishte efekt vetëm deklarativ; ndërsa për dallim, (ii) dispozitat e kontestuara të Kodit aktual të Procedurës Penale, i mundësojnë Gjykatës Supreme, që të vendosë edhe në dëm të të pandehurit, nëse vendimi i formës së prerë, është “qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”. Pretendimet e Gjykatës referuese, në esencë, mbështeten edhe nga Avokati i Popullit.

Aktgjykimi fillimisht sqaron që sipas paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës Penale, kur Gjykata Supreme çmon se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e paraqitur në dëm të të pandehurit, është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit, pa pasur ndikim në vendimin e formës së prerë. Kjo procedurë vlen si për vendimin e Gjykatës së Apelit lidhur me ndërprerjen e paraburgimit, ashtu edhe për vendimet e formës së prerë përmes të cilave ka përfunduar procedura penale ose është refuzuar aktakuza. Thënë këtë, përjashtimisht, bazuar në dispozitat e kontestuara të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata Supreme, përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, mund të vendosë edhe në dëm të të pandehurit, nëse vendimi i kontestuar i formës së prerë, është “qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë.” Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, Gjykata referuese pretendon që një

mundësi e tillë është në kundërshtim me parimin ne bis in idem, për faktin se (i) ndikon në rihapjen e vendimit të formës së prerë në dëm të të pandehurit; për më tepër që (ii) Kodi i Procedurës Penale, nuk përcakton qartë se kur një vendim i formës së prerë, është “i papërshtatshëm” ose “i bazuar në gabim të rëndë”.

Në kontekstin e lartcekur, Aktgjykimi sqaron parimet e përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa i përket parimit ne bis in idem të garantuar me nenin 34 [E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave, në parim, askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet dy herë për të njëjtën vepër penale për të cilën është dënuar ose liruar “përfundimisht”, përveç nëse rasti rihapet në përputhje me ligjin dhe procedurën penale, atëherë kur ka fakte të reja ose të zbuluara rishtazi ose ka pasur një mangësi fundamentale në procedurat e mëparshme. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që garancitë që ndërlidhen me parimin ne bis in idem të jenë të aplikueshme, duhet të plotësohen kriteret kumulative, përkatësisht të vlerësohet nëse: (i) të dy procedurat janë me natyrë “penale”; dhe nëse ky është rasti, (ii) të dy procedurat të jenë të ndërlidhura me të njëjtën vepër për të cilën një person është “liruar apo dënuar” me një “vendim përfundimtar”.

Sipas sqarimeve të dhëna, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sqaron karakteristikat e mjeteve juridike që mund të ushtrohen kundër një vendimi të formës së prerë, si dhe natyrën e një vendimi “përfundimtar”. Ndërlidhur me karakteristikat e mjetit juridik, praktika e lartcekur gjyqësore, ndër tjerash, përcakton që në vlerësimin nëse një mjet juridik është i “zakonshëm” apo i “jashtëzakonshëm”, si pikënisje merret ligji dhe procedurat e brendshme, por vlerësimi bazohet në karakteristikat e mjetit përkatës juridik dhe jo vetëm në emërtimin formal të tij, përkatësisht nëse i njëjti është në përputhje me parimin e sigurisë juridike, përfshirë në kontekst të (i) diskrecionit të kufizuar, gjithashtu në aspekt kohor, për përdorimin e atij mjeti juridik; dhe (ii) ekuilibrit ndërmjet palëve në mundësinë e shfrytëzimit të tij. Ndërsa, ndërlidhur me natyrën e vendimit “përfundimtar”, praktika e lartcekur gjyqësore, ndër tjerash, përcakton që (i) vendimi “përfundimtar” duhet të përfshijë shpalljen e “pafajësisë apo dënimit e personit”; dhe (ii) një vendim është “përfundimtar” në qoftë se i njëjti ka marrë fuqinë e gjësë së gjykuar apo res judicata,

përkatësisht, nëse vendimi është i parevokueshëm, që, ndër tjerash, nënkupton se kundër atij vendimi, nuk ka më mundësi parashtrimi të mjeteve juridike, kur palët i kanë shteruar këto mjete apo i kanë lënë të kalojnë afatet e përcaktuara me ligj pa i ushtruar ato.

Në aplikimin e këtyre parimeve, Aktgjykimi sqaron që, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës, mjete juridik i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë (i) mund të paraqitet brenda tre (3) muajve nga dorëzimi i vendimit të formës së prerë dhe rrjedhimisht, është qartësisht i kufizuar brenda një periudhe të arsyeshme kohore; dhe (ii) është i hapur si për të pandehurin, ashtu edhe për prokurorinë e shtetit, ndërsa (iii) mund të paraqitet në rastet e shkeljes së ligjit material dhe procedural, por jo për konstatim të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike. Në anën tjetër, sipas sqarimeve të dhëna, për aq sa është përdorur mjete juridik i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të formës së prerë, e njëjta procedurë penale vazhdon deri në vendimin “përfundimtar” të Gjykatës Supreme. Më saktësisht, vendimi i Gjykatës Supreme sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, është vazhdimësi e të njëjtës procedurë penale dhe nuk rezulton domosdoshmërisht në procedurë të dytë, përkatësisht procedurë të re penale për qëllime të nenit 34 [E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për pasojë, në rrethana të tilla, nuk mund të zbatohen garancitë e përcaktuara në nenin 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me rihapjen e një rasti, lidhur me të cilin një individ duhet të jetë dënuar ose liruar me “vendim përfundimtar”. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, për qëllime të dispozitave të lartcekura, Kodi i Procedurës Penale, ka paraparë mjetin e jashtëzakonshëm juridik të rishikimit të procedurës penale dhe i cili, për dallim nga mjete juridik i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, bie qartësisht në fushëveprimin e nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut. Për më tepër, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, është plotësisht e qartë që neni 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) i Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk gjen zbatim sa i përket rasteve të paraburgimit, sepse në atë procedurë, nuk vendoset sa i përket “lirimit apo dënimit” përfundimtar për vepër penale, pasi e njëjta ndërlidhet vetëm me sigurimin e prezencës së të pandehurve në procedurën penale, e cila është në zhvillim e sipër.

(ii) mundësia e Gjykatës Supreme që përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga Prokurori i Shtetit, përfshirë kundër vendimit të formës së prerë për ndërprerjen e paraburgimit, të vendosë edhe në dëm të të pandehurit në rast se vendimi i formës së prerë është “qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”

Fillimisht dhe ndërlidhur me mundësinë e Prokurorit të Shtetit për të kontestuar vendimin e Gjykatës së Apelit për ndërprerjen e paraburgimit në Gjykatën Supreme përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, Aktgjykimi, duke shtjelluar dhe interpretuar parimet që burojnë nga neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] i Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sqaron që Kodi i Procedurës Penale, mes tjerash, ka përcaktuar (i) paraburgimin si masë për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurë; (ii) procedurën sipas së cilës caktohet dhe vazhdohet paraburgimi, duke përcaktuar edhe të drejtën e ankesës ndaj vendimeve për paraburgim, si për të pandehurin ashtu edhe për Prokurorin e Shtetit; (iii) të drejtën që ndaj vendimit të formës së prerë, të parashtrohet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe atë si në rastin e caktimit dhe vazhdimin të paraburgimit, ashtu edhe në rastin e ndërprerjes së paraburgimit; (iv) që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të përdoret nga ana e prokurorisë ndaj vendimit për ndërprerje të paraburgimit, ashtu siç mund të përdoret nga i pandehuri ndaj vendimit për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit; dhe se sipas Kodit të Procedurës Penale, (v) të gjitha të drejtat në procedurë që janë në dispozicion për prokurorinë, janë po ashtu në dispozicion edhe për të pandehurin, dhe si të tilla, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, respektojnë, parimin e “kontradiktoritetit” dhe atë të “barazisë së armëve”.

Thënë këtë, kontestuese ndërlidhur me dispozitat e kontestuarat të Kodit të Procedurës Penale, është nëse, përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme, mund të vendosë edhe në dëm të të pandehurit, përfshirë në raste të paraburgimit. Në këtë kontekst dhe sa i përket efekteve të vendimmarrjes së Gjykatës Supreme përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në dëm të të pandehurve, Aktgjykimi rithekson që bazuar në paragrafin 1 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës, kur Gjykata Supreme vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, vendosë me aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes: (i) ndryshon vendimin e formës së prerë; (ii) në tërësi ose pjesërisht e anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë dhe e kthen rastin në rigjykim;

ose (iii) kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit, ndërsa bazuar në paragrafin 2 të këtij neni, i cili edhe është kontestuar para Gjykatës, Gjykata Supreme, përjashtimisht mund të vendosë edhe në dëm të të pandehurit, nëse vendimi i formës së prerë është “qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”.

Në vijim të të lartcekurave Aktgjykimi sqaron që, në parim, në rrethana në të cilat, Gjykata Supreme vlerëson që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur në dëm të të pandehurit, është e bazuar, ajo kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit, përkatësisht nxjerr vendim deklarativ. Thënë këtë dhe përjashtimisht, e njëjta (i) ndryshon vendimin e formës së prerë; ose (ii) në tërësi ose pjesërisht e anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë dhe e kthen rastin në rigjykim në dëm të të pandehurit, atëherë kur një vendim është “qartazi të papërshtatshëm” ose “i bazuar në gabim të rëndë”. Sipas sqarimeve të dhëna, rrethanat në të cilat, vendimmarrja e Gjykatës Supreme mund të rezultojë me efekt në dëm të të pandehurit, ngërthejnë shkelje shumë serioze ligjore, procedurale apo materiale, të cilat e vënë në pikëpyetje në tërësinë e saj integritetin e vendimmarrjes që ka rezultuar në vendim të formës së prerë. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, çdo vendimmarrje e Gjykatës Supreme, përfshirë bazuar në mekanizmat ligjorë për të siguruar konsistencë në praktikën e saj gjyqësore, në dëm të të pandehurit, duhet të jetë në përputhje të plotë me përjashtimet që mundëson praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas detyrimeve që burojnë nga neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës dhe mund t'i nënshtrohet vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese sipas përcaktimeve të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

Në fund, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi vë theks në faktin që në rast se Gjykata Supreme, përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, përjashtimisht, konstaton se vendimi i kontestuar është “qartazi i papërshtatshëm apo i bazuar në gabim të rëndë”, ajo është e detyruar që t'i ofrojë palëve të gjitha garancitë procedurale të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Më saktësisht, në përcaktimin nëse e njëjta, (i) ndryshon vendimin e formës së prerë; apo (ii) në tërësi ose pjesërisht e anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë dhe e kthen rastin në rigjykim, ajo duhet të bëjë ato zgjidhje ligjore që konsideron që sigurojnë të drejtat e të pandehurve në procedurë, ashtu siç garantohen me Kushtetutë, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kodin e

Procedurës Penale, me theks në garancitë që burojnë nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që përcaktojnë, mes tjerash, (i) të drejtën për t'u dëgjuar; (ii) parimin e “kontradiktoritetit” dhe të “barazisë së armëve”; dhe (iii) të drejtën për mjete juridike dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.



Aktgjykim

KO232/23 dhe KO233/23

Parashtrues

Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë; dhe Besian Mustafa dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka vendosur lidhur me kërkesat e bashkuara në rastet (i) KO232/23, me parashtrues: Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë; dhe (ii) KO233/23, me parashtrues: Besian Mustafa dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të dorëzuara në Gjykatë bazuar në autorizimet e përcaktuara në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Gjykata, ka vendosur që (i) njëzëri, të deklarojë kërkesën e pranueshme; dhe të konstatojë (ii) njëzëri, që nenet 2, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës dhe të shpallë të njëjtat të pavlefshme; (iii) me shtatë (7) vota për dhe dy (2) vota kundër, që neni 6 i Ligjit të kontestuar, nuk është në



përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës dhe të shpallë të njëjtin të pavlefshëm; (iv) njëzëri, që nenet 9, 10 dhe 11 të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të shpallë të njëjtat të pavlefshme; dhe (v) njëzëri, që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të shpallë që Ligji nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për dekretim sipas modaliteteve të përcaktuara në Aktgjykimin e Gjykatës dhe pa nenet 2, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit të kontestuar.

Aktgjykimi fillimisht sqaron që, Ligji i kontestuar ndryshon dhe plotëson Ligjin nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në katër aspekte kryesore. Së pari, ndryshon përbërjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga shtatë (7) në pesëmbëdhjetë (15) anëtarë, duke ndryshuar dhe/ose plotësuar edhe aspekte që ndërlidhen me kriteret dhe procedurën për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Së dyti, eliminon dispozitën aktuale ligjore që garanton imunitetin në vendimmarrje të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Së treti, zhvesh Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës nga kompetenca për të vendosur lidhur me ankesat e nëpunësve civilë dhe/ose kandidatëve për pranim në shërbimin civil në pozita të larta drejtuese kundër vendimeve të Qeverisë, përkatësisht pamundëson ankesat e të njëjtëve në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës ndaj vendimeve të Qeverisë, por duke u garantuar të drejtën e ankesës në gjykatën kompetente në konflikt administrativ. Ndërsa, së katërti, për dallim nga ligji në fuqi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, statusin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës si të ekzekutueshme, e kushtëzon ose në mungesën e ankesës në gjykatën kompetente ose në rast të ankesës, në nxjerrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga gjykata kompetente.

Deputetët parashtrues të Kuvendit e kontestojnë Ligjin e lartcekur si për nga procedura e ndjekur për miratimin e tij, ashtu edhe për nga përmbajtja e tij. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, (i) në kontekst të së parës, parashtruesit e kërkesës, në thelb, pretendojnë se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenin 77 (Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit) të Rregullores së Punës së Kuvendit; ndërsa (ii) në kontekst të së dytës, në thelb, pretendojnë që Ligji i kontestuar është në

kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, ndër tjerash dhe në esencë, sepse (i) cenon të drejtat dhe liritë themelore të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues për shkak se u pamundëson ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për dallim nga nëpunësit tjerë civilë, duke ua mohuar për pasojë, të drejtën në mjet juridik dhe për më tepër, në të njëjtën kohë, zhvesh Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës nga kompetenca kushtetuese për të siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil sipas përcaktimeve të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës; (ii) cenon pavarësinë vendimmarrëse të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, duke eliminuar garancitë për imunitetin në vendimmarrje, në kundërshtim me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës; si dhe (iii) cenon kompetencat kushtetuese të Këshillit Pavarur Mbikëqyrës, përfshirë të drejtat e palëve për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, marrë parasysh që eliminohet efekti i “ekzekutueshmërisë” së vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës deri në vendimin e formës së prerë të gjykatave të rregullta.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në parim, mbështeten edhe nga Avokati i Popullit dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ndërsa kundër-argumentohen nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Këta të fundit kundër-argumentojnë se Ligji i kontestuar është në përputhje me Kushtetutën, në esencë, sepse (i) Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nuk është Agjenci e Pavarur e Kuvendit dhe që burimi i kompetencave të Këshillit është Kuvendi; (ii) Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nuk mund të kufizojë kompetencat e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe që vendimmarrja e saj nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë nga “një trupë kuazi gjyqësore”; (iii) duhet të bëhet dallimi në mes të kategorive të shërbimit civil bazuar në peshën e tyre të përgjegjësisë, kompetencave dhe rolit të përgjithshëm në sigurimin e funksionimit të administratës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës nuk mund të mbivendosë vendimmarrjen e Qeverisë lidhur me nëpunësit civilë dhe/ose kandidatët për pranim në shërbimin civil në pozita të larta drejtuese, ndërsa të cilëve nuk u cenohet e drejta në mjet juridik, sepse u garantohet ankesa në gjykatat e rregullta përmes konfliktit administrativ; (iv) është në kompetencën e Kuvendit të vlerësojë nevojën e garantimit të imunitetit lidhur me vendimmarrjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur ose



jo; dhe (v) vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës mund të bëhen “të ekzekutueshme” vetëm pas vendimmarrjes së gjykatave të rregullta sepse vendimet e Këshillit nuk mund t’i mbivendosen atyre të Qeverisë.

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Gjykata fillimisht dhe ndër tjerash, ka shtjelluar (i) parimet themelore kushtetuese lidhur me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe raportin e tij me pushtetin ekzekutiv, siç është saktësuar në kapitullin VI [Qeveria e Republikës së Kosovës] të Kushtetutës; (ii) parimet themelore kushtetuese lidhur me barazinë para ligjit dhe të drejtën në mjet efektiv juridik; dhe (iii) parimet e vendosura nga Gjykata përmes praktikës së saj tashmë të konsoliduar gjyqësore ndërlidhur me funksionin dhe kompetencat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës që burojnë nga neni 101 [Shërbimi Civil] i Kushtetutës, përfshirë pavarësinë vendimmarrëse të anëtarëve të tij, me theks por duke mos u kufizuar në Aktgjykimet e Gjykatës në rastet (a) KO171/18 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; (b) KO127/21 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 08-V-29] të Kuvendit të Republikës së Kosovës të 30 qershorit 2021 për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; dhe (c) KO216/22 dhe KO220/22 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Në aplikimin e parimeve të lartcekura në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Aktgjykimi fillimisht thekson që (i) neni 101 [Shërbimi Civil] i Kushtetutës themelon një Këshill të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me kompetencën kushtetuese për të siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës; (ii) praktika gjyqësore e Gjykatës, ndër vite, ka sqaruar dallimin në mes të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe Agjencive të Pavarura të themeluara bazuar në nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, duke theksuar, në parim, që përderisa themelimi, përfshirë përcaktimi i funksionit dhe kompetencave të Agjencive të Pavarura, janë në kompetencën e Kuvendit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, është organ i themeluar me Kushtetutë dhe kompetencat kushtetuese të të njëjtit, nuk mund të cenohen përmes ligjeve të Kuvendit; dhe (iii) përderisa Kuvendi ka kompetencën e plotë për të saktësuar përmes ligjeve rolin e Këshillit në ushtrimin e funksionit për të siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, Kuvendi duhet të respektojë pavarësinë dhe kompetencën e Këshillit sipas përcaktimeve të Kushtetutës.

Në Aktgjykimin e Gjykatës, parimet e sqaruara si më sipër, janë aplikuar në shqyrtimin e secilit nen të vlerësuar të Ligjit të kontestuar veç e veç. Thënë këtë dhe për qëllime të kësaj përmbledhjeje, në vijim do të sqarohen të gjeturat dhe konstatimet kryesore përkitazi me çështjet më kontestuese të Ligjit të kontestuar, përkatësisht (i) përjashtimin nga kompetenca e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të vendimmarrjes lidhur me vendimet e Qeverisë për sa i përket kandidatëve për pranim dhe nëpunësve civilë në pozita të larta të drejtuese si dhe pamundësinë e këtyre të fundit që t’i drejtojnë ankesat e tyre në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës; (ii) heqjen e imunitetit për vendimmarrje të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; dhe (iii) zhveshjen e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga “ekzekutueshmëria” e tyre, deri në nxjerrjen e një vendimi të formës së prerë të gjykatave të rregullta.

(i) përjashtimi i kompetencës vendimmarrëse të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës lidhur me vendimet e Qeverisë për sa i përket kandidatëve për pranim dhe nëpunësve civilë në pozita të larta drejtuese

Aktgjykimi fillimisht sqaron që përmes neneve 2, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar ndryshohen dhe plotësohen nenet 6 (Funksionet e Këshillit), 16 (Shqyrtimi i ankesave) dhe 19 (Procedura e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues) të Ligjit bazik, duke shfuqizuar kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për (i) shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Qeverisë për përzgjedhjen e nëpunësve civilë në pozitë të larta drejtuese; si dhe (ii) mbikëqyrjen e procedurës së përzgjedhjes së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, nenet e lartcekura ngritin dy (2) çështje kushtetuese, përkatësisht (i) kompetencën kushtetuese të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për të siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës; dhe (ii) barazinë para ligjit në lidhje me të drejtën në mjet juridik, në kontekst të kandidatëve për pranim dhe nëpunësve civilë në pozitë të larta drejtuese në raport me kategoritë tjera të shërbimit civil.

Në kontekst të çështjes së parë, Aktgjykimi vë theks në praktikën e konsoliduar gjyqësore të Gjykatës, përfshirë (i) Aktgjykimin e saj në rastin KO171/18, përmes të cilit është shtjelluar kompetenca e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për sigurimin e respektimit të rregullave të shërbimit civil lidhur me të gjitha kategoritë e shërbyesve civil, pa përjashtim; dhe (ii) Aktgjykimin e saj në rastin KO216/22 dhe KO220/22, përmes të cilit është bërë vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Zyrtarët Publik, dhe i

cili, në kualifikimin e shërbimit civil përfshin edhe zyrtarët, përkatësisht nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues dhe për më tepër, i njëjti në shtjellimin e të drejtës në ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, nuk bën dallimin në mes të kategorive të nëpunësve civilë, duke u mundësuar të gjithëve të drejtën për të paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për çdo veprim apo mosveprim të autoriteteve që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, Kushtetuta i përcakton Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës kompetencën për të siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, dhe një kompetencë e tillë vlen për të gjitha kategoritë, të cilat, bazuar në ligjet e aplikueshme, hyjnë në fushëveprimin e shërbimit civil. Për më tepër, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është institucion i themeluar në kapitullin kushtetues mbi Qeverinë e Republikës së Kosovës, ndërsa Ligji i kontestuar e përjashton kompetencën vendimmarrëse të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës pikërisht vetëm lidhur me vendimet e Qeverisë.

Më tej dhe në kontekst të çështjes së dytë, Aktgjykimi, duke aplikuar parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, përfshirë ajo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me barazinë para ligjit dhe të drejtën në mjet juridik, ndër tjerash, sqaron që bazuar në ligjet e aplikueshme, kandidatët për pranim dhe nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese, hyjnë në përkufizimin e shërbimit civil dhe si të tillë, janë në pozita “relativisht të ngjashme dhe/ose analoge” me kategoritë tjera të shërbimit civil. Për pasojë, dallimet e përcaktuara në Ligjin e kontestuar në kontekst të barazisë së qasjes në mjet juridik, përkatësisht qasjes në vlerësimin dhe vendimmarrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, rezultojnë në “dallim në trajtim”, dhe i cili, përderisa është “i përcaktuar me ligj” dhe mund të ndjekë një “qëllim legjitim”, nuk është “proporcional” me qëllimin e ndjekur, ndër tjerash, sepse përkundër kompetencës kushtetuese të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për të siguruar respektimin e rregullave të shërbimit civil, dhe për dallim nga të gjitha ligjet tjera të aplikueshme, përfshirë Ligjin për Zyrtarët Publik, përjashton nga mbikëqyrja e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës vetëm kategorinë e lartcekur dhe atë vetëm në raport me vendimmarrjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për pasojë dhe sipas shtjellimeve të dhëna në Aktgjykim, Gjykata ka konstatuar që nenet 2, 7 dhe 8 të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të

Kushtetutës.

(ii) heqja e imunitetit për vendimmarrje të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës

Aktgjykimi fillimisht sqaron që neni 6 i Ligjit të kontestuar eliminon në tërësinë e tij paragrafin 3 të nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik, i cili përcakton që Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi.

Në kontekstin e lartcekur, Aktgjykimi vë theks në faktin që pavarësia vendimmarrëse e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është shqyrtuar specifikisht përmes dy Aktgjykimeve të Gjykatës, në rastet KO171/18 dhe KO127/21, respektivisht. Përmes (i) Aktgjykimit të parë, Gjykata ka vlerësuar pikërisht kushtetutshmërinë e paragrafit 3 të nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik, i cili shfuqizohet përmes Ligjit të kontestuar, duke e cilësuar të njëjtin si në përputhshmëri me nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës; ndërsa përmes (ii) Aktgjykimit të dytë, Gjykata ka shpallur në kundërshtim me Kushtetutën shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për shkak të vendimmarrjes së tyre në raste konkrete. Përmes të dy Aktgjykimeve, Gjykata, ndër tjerash, ka theksuar që (i) pavarësia kushtetuese e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është e kushtëzuar nga pavarësia në vendimmarrje e anëtarëve të tij; (ii) pavarësia kushtetuese e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj u atribuon imunitet anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, duke ua mundësuar kështu që të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre në lidhje me “pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre”; (iii) pavarësisht se Kuvendi ka kompetencë kushtetuese të mbikëqyr Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës sipas përcaktimeve të saktësuara në ligjin e miratuar nga vet Kuvendi, duke përfshirë mundësinë e shkarkimit të anëtarëve të tij në rrethanat e saktësuara në ligjin e aplikueshëm për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, anëtarët e tij nuk mund të shkarkohen për vendimmarrje. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, një mundësi e tillë, bazuar në të cilën anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës do të mund të shkarkoheshin për vendimmarrjen e tyre, do të cenonte thellë pavarësinë funksionale të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe vet



qëllimin e ekzistencës së tij, sipas përcaktimeve të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës dhe të ligjeve të aplikueshme. Për më tepër, Aktgjykimi rithekson faktin që ligjshmëria e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor dhe jo atij legjislativ dhe/ose ekzekutiv.

Për pasojë dhe sipas shtjellimeve të dhëna në Aktgjykim, Gjykata ka konstatuar që neni 6 i Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

(iii) zhveshja e vendimeve të Këshillit të Pavarur nga “ekzekutueshmëria” e tyre deri në vendimin e formës së prerë të gjykatave të rregullta

Aktgjykimi fillimisht sqaron që përmes neneve 9, 10 dhe 11 të Ligjit të kontestuar ndryshohen dhe plotësohen nenet 21 (Vendimi i Këshillit), 22 (Inicimi i Konfliktit Administrativ) dhe 23 (Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit) të Ligjit bazik, duke përcaktuar që vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk kanë statusin si të “ekzekutueshme”, përkatësisht duke përcaktuar që të njëjtat bëhen të “ekzekutueshme” (i) vetëm pas kalimit të afateve për ankesë në gjykatat e rregullta; ose (ii) në rast ankese, vetëm pasi vendimi i gjykatave të rregullta të ketë marrë formën e prerë.

Në kontekstin e lartcekur, Aktgjykimi shtjellon praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës, përfshirë në kontekst të kërkesave individuale dhe të cilat kanë ngritur, në esencë, rëndësinë e “ekzekutueshmërisë” të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, përfshirë në kontekst të garancive kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe efektivitetit të mjetit juridik. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente, ka saktësuar që vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, i cili ka cilësitë e një “kuazi-tribunali” në kontekst të detyrimeve që burojnë nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë vendime “përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme” në procedurë administrative. Aktgjykimi më tej rithekson që, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka juridiksion të plotë për të vendosur për çështjet që ndërlidhen me sigurimin e respektimit të rregullave të shërbimit civil, ndërsa vlerësimi i ligjshmërisë së këtyre vendimeve i takon gjykatave të rregullta, të cilat, bazuar në ligjin e aplikueshëm për konfliktet administrative, kanë kompetencën e plotë për të pezulluar ekzekutimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës përmes vendosjes së masave të përkohshme, atëherë kur bazuar në vlerësimin e

gjykatave kompetente janë plotësuar kriteret e përcaktuara me ligj. Sipas sqarimeve të dhëna, zhveshja e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga statusi i vendimeve të “ekzekutueshme”, për aq sa vet gjykatat nuk e kanë ndaluar ekzekutimin e tyre sipas përcaktimeve të ligjeve të aplikueshme, cenon efektivitetin e kompetencës kushtetuese të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për të siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil të Republikës së Kosovës sipas përcaktimeve të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

Për pasojë dhe sipas shtjellimeve të dhëna në Aktgjykim, Gjykata ka konstatuar që nenet 9, 10 dhe 11 të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Në fund, Aktgjykimi sqaron që bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës rezulton që (i) procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar, nuk është argumentuar të jetë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe se (ii) nenet 3, 4 dhe 5 të Ligjit të kontestuar, të cilat ndryshojnë dhe plotësojnë nenet 8 (Përbërja e Këshillit), 9 (Kriteret për emërimin e anëtarit të Këshillit) dhe 10 (Procedura për emërimin e anëtarëve të Këshillit) të Ligjit bazik, nuk janë argumentuar të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

Aktgjykimi gjithashtu sqaron që, kërkesat e parashtruesve të kërkesës janë parashtruar në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe se kjo kategori e kërkesave ka karakter suspensiv, përkatësisht ligji i tillë mund t'i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje vetëm pas vendimmarrjes së Gjykatës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës. Në kontekst të praktikës së saj gjyqësore, siç është shtjelluar edhe në Aktgjykim, duke marrë parasysh që pjesa e mbetur e Ligjit të kontestuar mund të zbatohet pa dispozitat e shpallura si në kundërshtim me Kushtetutën, Gjykata vendosi që Ligji nr.08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, t'i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje, pa nenet 2, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të tij, të cilat janë vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën dhe si të tilla, janë shpallur të pavlefshme.



Aktgjykim

KO46/23

Parashtrues

Abelard Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vendosur në rastin KO46/23, me parashtrues Abelard Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese bazuar në autorizimet e paragrafit 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

Gjykata ka vendosur që (i) njëzëri, të deklarojë kërkesën e pranueshme; dhe (ii) të konstatojë, me tetë (8) vota për dhe një (1) votë kundër, që pika 2.1 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 2 të nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) të konstatojë, me tetë (8) vota për dhe një (1) votë kundër, që pika 2.2 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 3 të nenit 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (iv) të konstatojë, me gjashtë (6) vota për dhe tri (3) vota kundër, që pika 1.1 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me nenin 106 [Papajtuueshmëria] të Kushtetutës; (v) të konstatojë,

me tetë (8) vota për dhe një (1) votë kundër, që pika 1.2 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës; (vi) të konstatojë, me gjashtë (6) vota për dhe tri (3) vota kundër, që pika 1.4 e paragrafit 1 të nenit 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe paragrafin 3 të nenit 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës; dhe (vii) të shpallë të pavlefshëm, me pesë (5) vota për dhe katër (4) vota kundër, në tërësinë e tij, Ligjin nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

Aktgjykimi fillimisht sqaron që, Ligji i kontestuar themelon Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme (Byroja Shtetërore), duke e përfshirë në rendin juridik të Republikës së Kosovës edhe konceptin e konfiskimit civil të pasurisë së pajustificueshme, përkatësisht dhe në esencë, konfiskimin e pasurisë pa nevojën e vërtetimit në procedurë penale që pasuria përkatëse është fituar përmes kryerjes së veprës penale. Për këtë qëllim, Ligji i kontestuar, përcakton procedurën për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme nga personat zyrtarë dhe palët e treta, përkatësisht çdo person fizik apo juridik tek të cilët pasuria e personit zyrtar është bartur apo që ka ose mund të ketë pasur interes juridik mbi pasurinë e palëve në procedurë. Sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar, verifikimit i nënshtrohet pasuria e fituar në mënyrë të pajustificuar duke filluar nga 17 shkurti 2008 dhe në parim, brenda dhjetë (10) viteve nga momenti kur zyrtarët përkatës pushojnë së ushtruar funksionet e tyre, me saktësimin që verifikimit të pasurisë, përjashtimisht mund të i nënshtrohet edhe pasuria e fituar pas përfundimit të ushtrimit të funksionit zyrtar. Byroja e lartcekur, ka kompetencën për të vlerësuar masën pasurore të secilit zyrtar në raport me të hyrat e ligjshme dhe në rast të vlerësimit që ka shpërputhje në mes të hyrave dhe pasurisë që tejkalon vlerën prej njëzetepesëmijë (25,000) euro, mund të propozon sigurimin e pasurisë përmes masës së përkohshme dhe më pas, konfiskimin e të njëjtës pas vendimit përkatës gjyqësor. Marrë parasysh që procedura e verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme është e pavarur nga procedura penale, standardi i të provuarit nuk është ai penal i “dyshimit të bazuar”, por ai civil i “vlerësimit të



gjasave” dhe sipas të cilit, pasuria cilësohet e pajustificueshme, nëse gjykata bazuar në prova “beson që një gjë ka më shumë mundësi të jetë apo të ketë ndodhur se sa jo”. Për më tepër, dhe përderisa Byroja Shtetërore ka barrën fillestare të argumentimit që pasuria konfiskimi i të cilës propozohet është e pajustificuar, barra për të dëshmuar që pasuria në fakt është e justifikueshme, bie mbi individin. Duhet të theksohet gjithashtu që, përderisa Byroja Shtetërore ka kompetencën e plotë për verifikimin dhe propozimin për konfiskimin e pasurisë, janë gjykatat ato të cilat kanë kompetencën për të vendosur nëse pasuria kontestuese i nënshtrohet konfiskimit ose jo. Aktgjykimi gjithashtu sqaron që, për qëllime të verifikimit dhe propozimit të konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme, Ligji i kontestuar, themelon Byronë Shtetërore, e cila udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm me mandat shtatë (7) vjeçar, ndërsa mbikëqyret nga një Komision Mbikëqyrës i përbërë nga (i) një gjyqtar i Gjykatës Supreme i caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, në cilësinë e kryesuesit të Komisionit; (ii) Auditori i Përgjithshëm; (iii) Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; (iv) zëvendës Avokati i Popullit; dhe (v) Drejtori i Njësisë së Inteligjencës Financiare. Ky Komision, i cili vendos me shumicën e anëtarëve në kuadër të kuorumit vendimmarrës prej katër (4) anëtarësh, ka kompetencën e plotë mbikëqyrëse të të gjitha funksioneve të Byrosë Shtetërore, përfshirë miratimin e të gjitha akteve nënligjore.

Thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, ndërlidhet me cenimin (i) e parimeve të sundimit të ligjit dhe parimit të sigurisë juridike, si vlera thelbësore të rendit kushtetues; dhe (ii) e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, përfshirë instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare. Në esencë, parashtruesit e kërkesës parashtrojnë tri kategori çështjesh para Gjykatës. Së pari, pretendojnë që mekanizmat e përcaktuar përmes Ligjit të kontestuar për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë nuk ngërthejnë garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, sidomos në kontekst (i) të barazisë para ligjit, marrë parasysh faktin që ligji i aplikueshëm bën dallimin në mes personave zyrtarë dhe qytetarëve tjerë të Republikës së Kosovës dhe vet personave zyrtarë që kanë ushtruar funksione para dhe pas 17 shkurtit 2008; (ii) të garancive procedurale që ndërlidhen me verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë, përfshirë të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përkatësisht barazisë së armëve, prezumimit të pafajësisë, barrës së provës, të drejtës për t’u mos inkriminuar dhe mjeteve juridike; dhe (iii) të drejtave pronësore të subjekteve të verifikimit. Së dyti, pretendojnë që aplikimi retroaktiv i ligjit, përtej

cenimit të të drejtave dhe lirive themelore, cenon edhe parimin e sigurisë juridike dhe vlerat e Kushtetutës. Së treti, pretendojnë cenimin e kompetencave të Kuvendit për mbikëqyrjen e Agjencive të Pavarura, për arsye se në rrethanat e rastit konkret, kompetenca mbikëqyrëse e Kuvendit është transferuar në një Komision Mbikëqyrës, i cili, për më tepër, karakterizohet me papajtueshmëri kushtetuese funksionesh, me theks në zëvendës Avokatin e Popullit, ndërsa gjithashtu duke vënë theks në mungesën e pavarësisë së Byrosë Shtetërore, përfshirë në kontekst të mënyrës së zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të saj.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës, kundërshtohen nga Ministria e Drejtësisë dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, në esencë, duke theksuar që (i) Ligji i kontestuar ngërthen garanci të mjaftueshme procedurale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe që përmbajtja e të njëjtit është vlerësuar pozitivisht edhe nga Opinionet e Komisionit të Venecias; (ii) dallimi në mes personave zyrtarë dhe qytetarëve tjerë të Republikës së Kosovës, ndjek një qëllim legjitim të luftimit të korrupsionit në sektorin publik, për më tepër që, aplikimi retroaktiv i ligjit nuk është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike; ndërsa (iii) sqarojnë që data 17 shkurt 2008, ndërlidhet edhe me “qarkullimin juridik të pronës nëpërmjet transaksioneve bankare”, e që për qëllime të këtij ligji, përbën provë vendimtare sa i përket verifikimit të pasurisë; (iv) themelimi i Komisionit Mbikëqyrës nuk cenon kompetencën mbikëqyrëse të Kuvendit, për më tepër që, kalimi i kompetencës për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm nga Kuvendi në Komisionin Mbikëqyrës, si mekanizëm de-blokimi në rast se procedura e përzgjedhjes së Drejtorit dështon në Kuvend, është zgjidhje në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Gjykata, në Aktgjykimin e saj, përkatësisht në dritën e shtjellimit të konceptit të konfiskimit civil të pasurisë së pajustificueshme bazuar në standardin ndërkombëtar dhe praktikën e vendeve që zbatojnë konfiskimin civil, fillimisht theksoi rëndësinë e qëllimit legjitim të Ligjit të kontestuar sa i përket interesit publik dhe luftimit të korrupsionit në sektorin publik. Thënë këtë, në kuptim të vlerësimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, si dhe kundër-argumenteve të palëve të interesuara, Aktgjykimi, ndër tjerash, gjithashtu shtjellon (i) parimet e përgjithshme lidhur me konceptin e konfiskimit civil të pasurisë së pajustificueshme sipas praktikës ndërkombëtare; (ii) praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) që ndërlidhet me konfiskimin e pasurisë dhe barrën e të provuarit,



përfshirë në kontekst të “ndërhyrjes” në të drejtat pronësore të individëve si rezultat i konfiskimit të pasurisë në procedurë civile; (iii) dokumentet relevante të miratuara në nivel të Kombeve të Bashkuara, të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, përfshirë të gjitha Opinionet e Komisionit të Venecias në lidhje me konfiskimin civil të pasurisë, me theks në aspektet që ndërlidhen me rregullimet dhe garancitë institucionale për komisionet/agjencitë përgjegjëse për konfiskimin civil të pasurisë së pajustificueshme dhe çështjet që ndërlidhen me barrën e provës dhe aplikueshmërinë retroaktive të ligjit; dhe (iv) dy (2) Opinionet e Komisionit të Venecias për Kosovën përkitazi me Ligjin e kontestuar, të miratuara më 17-18 qershor 2022 dhe më 16-17 dhjetor 2022, respektivisht.

Në dritën e parimeve të lartcekura, përfshirë argumentet dhe kundër-argumentet e palëve, për qëllime të kësaj përmbledhjeje, në vijim do të paraqiten konstatimet më esenciale të Aktgjykimit lidhur me tri kategori gjithëpërfshirëse çështjesh, përkatësisht (i) fushëveprimin e Ligjit të kontestuar lidhur me barazinë para ligjit, sigurinë juridike dhe proporcionalitetin e aplikimit retroaktiv të ligjit në raport me barrën e provës së individit; (ii) garancitë procedurale në kontekst të verifikimit dhe/ose konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme; dhe (iii) çështjet institucionale, përkatësisht mekanizmat e mbikëqyrjes së Byrosë Shtetërore, përfshirë pa/pajtueshmërinë e funksioneve kushtetuese të anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës.

(i) Fushëveprimi i Ligjit – barazia para ligjit, siguria juridike dhe proporcionaliteti i aplikimit retroaktiv të ligjit në raport me barrën e provës së individit

Aktgjykimi fillimisht sqaron që në kontekst të fushëveprimit, Ligji i kontestuar, në parim, zbatohet ndaj pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme, përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të zyrtarëve publikë nga data 17 shkurt 2008 dhe brenda dhjetë (10) viteve nga momenti kur subjektet përkatëse pushojnë së ushtruar funksionin e tyre dhe që përjashtimisht, verifikimit mund të i nënshtrohet edhe pasuria e fituar pas periudhës së ushtrimit të funksionit publik, por jo më gjatë se pesë (5) vite pas përfundimit të funksionit publik të personit zyrtar. Sipas sqarimeve të dhëna, këto rregullime, në thelb, ngritin tri çështje të nivelit kushtetues, përkatësisht (a) parimin e barazisë para ligjit në mes të qytetarëve të Republikës së Kosovës, në dritën e faktit që verifikimit të pasurisë i nënshtrohen vetëm zyrtarët publikë dhe palët e treta të ndërlidhura me ta, përfshirë edhe barazinë para ligjit të vet zyrtarëve publikë, marrë parasysh që verifikimit i nënshtrohet vetëm pasuria e

fituar nga zyrtarët publikë pas 17 shkurtit 2008; (b) parimin e sigurisë juridike në kontekst të aplikueshmërisë retroaktive të Ligjit të kontestuar duke filluar më 17 shkurt 2008, përfshirë ndërlidhur me barrën e provës, e cila, pas propozimit të konfiskimit të pasurisë nga Byroja Shtetërore, bie në mënyrë retroaktive mbi individin; dhe (c) parimin e sigurisë juridike në kontekst të “qartësisë” dhe “parashikuershmërisë” së dispozitave të Ligjit të kontestuar, të cilat rregullojnë periudhën e verifikimit të pasurisë së pajustificueshme gjatë ushtrimit dhe pas përfundimit të funksioneve të zyrtarëve përkatës. Vlerësimet dhe konstatimet e Gjykatës ndërlidhur me çështjet e mësipërme, do të reflektohen në mënyrë të përmbledhur në vijim.

(a) barazia para ligjit në mes të zyrtarëve publikë dhe palëve të treta në raport me qytetarët tjerë të Republikës përkitazi me verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, përfshirë para dhe pas 17 shkurtit 2008

Në kontekst të trajtimit të (pa)barabartë në mes të zyrtarëve publikë dhe palëve të treta, në raport me qytetarët tjerë të Republikës përkitazi me verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, përfshirë para dhe pas 17 shkurtit 2008, Aktgjykimi, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së, së pari sqaron që kategoritë e lartcekura, janë në “situata relativisht të ngjashme dhe/ose analoge” dhe që Ligji i kontestuar, këto kategori i trajton në mënyra të ndryshme, duke rezultuar në “dallim në trajtim”. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ky “dallim në trajtim” nuk rezulton në cenim të parimit të barazisë para ligjit sepse, ndjek një “qëllim legjitim” të interesit publik dhe është “proporcional” me qëllimin e ndjekur, ndër tjerash, sepse duke u bazuar në interesin publik të luftimit të korrupsionit në sektorin publik, Ligji i kontestuar fokusohet në kategorinë e qytetarëve që janë paguar nga buxheti i shtetit, përkatësisht nga taksapaguesit e Republikës së Kosovës.

(b) aplikimi retroaktiv i ligjit në raport me barrën e provës ndërlidhur me pa/justifikueshmërinë e pasurisë

Në kontekst të aplikueshmërisë retroaktive të Ligjit të kontestuar në raport me parimin e sigurisë juridike, Aktgjykimi, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Opinionet e Komisionit të Venecias lidhur me sistemin civil të konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme dhe praktikën gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese, sqaron që, në parim, aplikimi retroaktiv i ligjit në fushën e të drejtës civile dhe administrative, është përjashtimisht i mundur, për aq sa është në interes të përgjithshëm publik dhe është



proporcional me qëllimin e ndjekur. Sipas sqarimeve të dhëna, aplikueshmëria retroaktive e Ligjit të kontestuar në kontekst të verifikimit të pasurisë së pajustificueshme, është në interes publik të luftës kundër korrupsionit. Kjo e fundit, e bën të domosdoshëm veprimin jo vetëm në të ardhmen por edhe adresimin e fitimit të paligjshëm të pasurisë në të kaluarën, për më tepër që në rrethana të tilla, nuk ndërhyhet ekskluzivisht vetëm në ngjarjet e kaluara por edhe në faktet në vazhdim, sepse pronësia e pasurisë së paligjshme ka filluar në të kaluarën, por ajo vazhdon më tutje, ndërsa pritshmëria e individit për të qenë në gjendje për të mbajtur pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme, nuk peshon në raport me interesin e publikut për të luftuar korrupsionin.

Thënë këtë dhe sipas sqarimeve të dhëna, kontestuese është nëse aplikimi retroaktiv i ligjit për një periudhë më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, përkatësisht nga 17 shkurti 2008, është proporcional me të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të verifikimit në kontekst të barrës së provës dhe i cili, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Opinioneve të Komisionit të Venecias, është i domosdoshëm në kontekst të arsyeshmërisë dhe/ose “mundësisë objektive” të individit për të siguruar dhe prezantuar dëshmitë e nevojshme në mbështetje të argumentimit të justifikueshmërisë së pasurisë që i nënshtrohet verifikimit dhe/ose konfiskimit. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, përderisa në propozimin për konfiskimin e pasurisë Byroja Shtetërore mbështetet nga detyrimi për bashkëpunim i të gjitha autoriteteve publike në Republikën e Kosovës, individit bart barrën e kundër-argumentimit, përkatësisht të provuarit e justifikueshmërisë së pasurisë, në rrethana në të cilat, Ligji i kontestuar, për dallim nga ligjet e ngjashme në shtetet që e kanë adaptuar sistemin e konfiskimit civil të pasurisë, nuk ngërthen asnjë garanci për individin për të argumentuar “pamundësinë objektive” për të disponuar me një dëshmi përgjatë një periudhe kohore e cila, në parim, tejkalon afatet e përcaktuara në ligjet e aplikueshme për mbajtjen/ruajtjen e të dhënave/regjistrave dhe/ose qasjes në dokumentacion/dëshmi të nevojshme.

Sipas sqarimeve të dhëna, për të vlerësuar proporcionalitetin në kontekst të periudhës së aplikueshmërisë retroaktive të Ligjit të kontestuar dhe barrës së provës të individit, e cila bazohet në vlerësimin e gjasave, përkatësisht sipas definicionit të ligjit, në besimin që “një gjë ka më shumë mundësi të jetë apo të ketë ndodhur se sa jo”, Aktgjykimi, ndër tjerash, vë theks në kontekstin e shtetndërtimit të Republikës së Kosovës, përfshirë miratimin dhe karakteristikat e ligjeve të aplikueshme që janë relevante për të dëshmuar raportin në mes të hyrave të

të ligjshme dhe pasurisë së fituar në kontekst të (i) sistemit të tatimit në të ardhurat personale; (ii) sistemit pensional; (iii) detyrimit ligjor të qarkullimit të parasë përmes transaksioneve bankare; (iv) deklarimit të pasurisë; dhe (v) konfiskimit të pasurisë së përfituar me vepër penale. Sipas sqarimeve të dhëna, në parim, rezulton që ligjet e aplikueshme nuk përcaktojnë detyrime për ruajtjen e të dhënave për një periudhë kohore me të gjatë se dhjetë (10) vjeçare dhe e cila, rrjedhimisht, tejkalon periudhën e aplikimit retroaktiv të Ligjit të kontestuar. Prandaj, sipas sqarimeve të dhëna, përkundër faktit që Ligji i kontestuar ndjek qëllimin legjitim të interesit publik, i njëjti në vlerësimin e Gjykatës, nuk reflekton një baraspeshë të arsyeshme në mes të shtetit dhe individit, ndër tjerash, sepse (i) periudha e aplikueshmërisë retroaktive të ligjit, në parim, tejkalon afatet e përcaktuara në ligjet relevante të aplikueshme në kontekst të mbajtjes së regjistrave dhe/ose të dhënave, (ii) në rrethana në të cilat, e tërë administrata shtetërore është e detyruar të bashkëpunojë me Byronë, ndërsa barra e provës rreth justifikueshmërisë së pasurisë kontestuese bie mbi individin, dhe (iii) i cili, nuk përfiton nga një garanci e arsyeshme procedurale, bazuar në të cilën, do të mund të argumentonte para gjykatës kompetente “pamundësinë objektive” për të siguruar dhe/ose paraqitur një provë që shkon në favor të justifikueshmërisë së pasurisë që është objekt verifikimi dhe/ose konfiskimi.

Për pasojë, Gjykata ka konstatuar që pika 2.1 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 2 të nenit 34 (Shqyrtimi në shkallën e parë) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, në adresimin e shkeljes së kontestuar si më lart, përmes ndryshimeve dhe/ose plotësimeve të dispozitave të lartcekura, Kuvendi duhet të sigurohet që aplikimi retroaktiv i ligjit të jetë i balancuar dhe/ose proporcional me barrën e të provuarit, ose (i) duke përcaktuar periudha të arsyeshme retroaktive bazuar në analizën dhe vlerësimin e ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, përfshirë në kontekst të qasjes në të dhëna që janë relevante për vërtetimin e pa-justifikueshmërisë së pasurisë; dhe/ose (ii) përmes përcaktimit të garancive procedurale në kontekst të barrës së të provuarit të individit, që do të i mundësonte këtij të fundit, që të argumentojë para gjykatave përkatëse ndërlidhur me “pamundësinë objektive” për të siguruar provat përkatëse.

(c) parimi i sigurisë juridike në kontekst të “qartësisë” dhe “parashikueshmërisë” së dispozitave të Ligjit të kontestuar, të cilat rregullojnë periudhën e verifikimit të pasurisë së paluajtshme gjatë ushtrimit dhe pas përfundimit të funksioneve të zyrtarëve përkatës

Aktgjykimi thekson që, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, procesi i verifikimit dhe/ose konfiskimit të pasurisë përbën një “ndërhyrje” në të drejtat pronësore të individit dhe, si i tillë, duhet të jetë i përcaktuar me ligj dhe proporcional me qëllimin e ndjekur. Në këtë kontekst, Aktgjykimi gjithashtu vë theks në domosdoshmërinë e “qartësisë” dhe “të parashikueshmërisë” së dispozitave ligjore që mund të afektojnë të drejtat pronësore të individit, përfshirë në kontekstin e rrethanave të rastit konkret, në aspekt retroaktiv. Sipas sqarimeve të dhëna, Ligji i kontestuar përcakton mundësinë e verifikimit dhe/ose konfiskimit të pasurisë së fituar gjatë ushtrimit të funksionit, dhe përjashtimisht pas përfundimit të funksionit, që në vlerësimin e Gjykatës, gjithashtu është në interesin e përgjithshëm të luftimit të korrupsionit në sektorin publik. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna, në kontekst të periudhës përgjatë të cilës pasuria mund të i nënshtrohet verifikimit dhe/ose konfiskimit të saj, dispozitat respektive të Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, nuk qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë të parashikueshme periudhat kohore përgjatë të cilave pasuria e fituar mund t’i nënshtrohet verifikimit, përfshirë periudhat kohore përgjatë të cilave mund të fillojë procedura e verifikimit të pasurisë, si për pasurinë e fituar gjatë ushtrimit të funksionit ashtu edhe për pasurinë e fituar pas përfundimit të funksionit përkatës. Sipas sqarimeve të dhëna, mungesa e një qartësie të tillë, u mundëson autoriteteve publike, përfshirë Byronë Shtetërore, që të interpretojnë afatet e përcaktuara në Ligjin e kontestuar në diskrecionin e tyre të plotë, në cenim të parimit të sigurisë juridike dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve, përfshirë duke u pamundësuar atyre që përshtatshëmrisht të rregullojnë sjelljen dhe pritshmëritë përkatëse.

Për pasojë, Gjykata ka konstatuar që pika 2.2 e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) në lidhje me paragrafin 3 të nenit 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) të Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, në adresimin e kësaj shkelje, Kuvendi, përmes ndryshimeve dhe/ose plotësimit të dispozitave të lartcekura, duhet të sigurohet që normat të cilat përcaktojnë periudhat kohore brenda të cilave Byroja Shtetërore mund të verifikojë pasurinë e fituar përgjatë dhe pas ushtrimit të funksionit, përfshirë ato

brenda të cilave mund të iniciohen hetimet dhe procedurat përkatëse, duhet të jenë plotësisht të “qarta” dhe “parashikueshme”.

(ii) Garancitë procedurale në kontekst të verifikimit dhe/ose konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme

Aktgjykimi sqaron që Ligji i kontestuar, ndër tjerash, rregullon procedurën e verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme, përfshirë të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurë dhe autorizimet e Byrosë Shtetërore, përfshirë në kontekst të (i) inicimit të procedurës; (ii) mbledhjes së informacionit me qëllim të verifikimit; (iii) detyrimit për bashkëpunim; (iv) procedurave para gjykatave të rregullta; dhe (v) mjeteve juridike dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave. Të gjitha çështjet e mësipërme, Aktgjykimi i analizon dhe sqaron në kontekst të garancive që burojnë nga nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, por edhe atyre që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe opinionet e Komisionit të Venecias, dhe në parim, konstaton që Ligji i kontestuar ndërlidhur me ligjet tjera të aplikueshme, ngërthejnë garanci të mjaftueshme procedurale për palët në procedurë.

Thënë këtë, marrë parasysh formulimin e dispozitave të Ligjit të kontestuar, Aktgjykimi vë theks në tri çështje parësore, përkatësisht (i) të drejtën për t’u mos inkriminuar; (ii) të drejtën e palës për t’u njoftuar për të gjitha procedurat e zhvilluara në kontekst të verifikimit të pasurisë, përfshirë ndërlidhur me vendosjen e masave të sigurisë në pasurinë kontestuese; dhe (ii) parimin e sigurisë juridike.

Në kontekst të çështjes së parë, përkatësisht detyrimit për bashkëpunim në raport me të drejtën për t’u mos inkriminuar, Aktgjykimi, ndër tjerash, sqaron që Byroja Shtetërore është e themeluar si Agjenci e Pavarur sipas përcaktimeve të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, bazuar në të cilin, secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t’u përgjigjet kërkesave të tyre gjatë ushtrimit të kompetencave, në pajtim me ligjin. Prandaj, sipas sqarimeve të dhëna, nuk është kontestues detyrimi që përcakton Ligji i kontestuar në kontekst të bashkëpunimit të autoriteteve publike me Byronë Shtetërore. Në anën tjetër dhe në kontekst të detyrimit për bashkëpunim të individëve, përfshirë palët në procedurë, Aktgjykimi, ndër tjerash, sqaron që Ligji i kontestuar (i) ngërthen garancinë bazuar në të cilën, për personat fizikë, përfshirë subjektin e verifikimit, detyrimi për bashkëpunim shtrihet deri në masën sa “nuk cenohet e drejta në privatësi dhe e

drejta për mos inkriminim” dhe që vlerësimi i një proporcioni të tillë është në kompetencën e gjykatës kompetente; për më tepër që (ii) pasoja e refuzimit për bashkëpunim, përkatësisht mundësia për kallëzim penal për veprën penale “mos ekzekutim i vendimit gjyqësor”, sipas përcaktimeve të Kodit Penal, nuk shtrihet ndaj personit fizik, por vetëm ndaj autoriteteve publike dhe/ose personave fizikë dhe juridikë me autorizime publike.

Në kontekst të çështjes së dytë dhe të tretë, përkatësisht detyrimit të njoftimit të palës, përfshirë lidhur me vendosjen e masave të sigurisë dhe parimin e sigurisë juridike, Aktgjykimi, ndër tjerash, thekson që (i) Ligji i kontestuar, në parim, ofron mjaftueshëm garanci në kuadër të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi i mundëson subjektit të verifikimit qasje në informacionet e pranuar dhe të trajtuara, ndërsa kufizimi në qasjen e tyre, mund të përcaktohet vetëm nga gjykata kompetente, vendim ky i cili mund të ankimohet nga subjekti përkatës; (ii) bazuar në parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, pala duhet të jetë e njoftuar përgjatë gjithë procesit, përfshirë në kontekst të procedurave të ndjekura përkitazi me vendosjen e masave të sigurisë mbi pasurinë kontestuese, dhe që vendosja e një mase të sigurisë pa njoftimin paraprak të palës, është e mundur vetëm përjashtimisht nën garancitë e rrepta që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së; dhe (iii) marrë parasysh parimin e sigurisë juridike, përfshirë detyrimin që normat e aplikueshme të jenë të “qarta” dhe të “parashikueshme”, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurë duhet të jenë të përcaktuara me ligj dhe jo përmes akteve nënligjore.

Aktgjykimi në fund sqaron që, vlerësimi i Gjykatës që, Ligji i kontestuar, në parim, ofron garanci të mjaftueshme procedurale për palët në procedurë, nuk e nënkupton edhe ligjshmërinë dhe/ose kushtetutshmërinë e vendimeve të Byrosë Shtetërore dhe/ose gjykatave të rregullta. Aktgjykimi vë theks në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, duke rikujtuar që të gjitha autoritetet publike janë të detyruara të i interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore në përputhshmëri me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

(iii) Mbikëqyrja e Byrosë Shtetërore – transferimi i mbikëqyrjes nga Kuvendi në Komisionin Mbikëqyrës dhe pa/pajtueshmëria e funksioneve kushtetuese të anëtarëve të këtij Komisioni

Në kontekst të organizimit institucional të Byrosë Shtetërore, Aktgjykimi, ndër tjerash, fokusohet në tri karakteristikat kryesore të tij, përkatësisht (a) statusin e Byrosë Shtetërore në kontekst të rendit juridik të

Republikës së Kosovës, përfshirë faktin që e njëjta është themeluar bazuar në nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, por që mbikëqyrja e ushtrimit të funksioneve të saj nuk është lënë në kompetencë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, por të një Komisioni Mbikëqyrës të përbërë nga përfaqësues të institucioneve dhe/ose agjencive të pavarura; (b) përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës, përfshirë pajtueshmërinë e funksioneve kushtetuese të anëtarëve të tij në raport me natyrën e përgjegjësive të këtij Komisioni dhe kompetencave të Byrosë Shtetërore; dhe (c) mënyrën e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore.

(a) kompetenca mbikëqyrëse e Kuvendit në raport me statusin e Byrosë Shtetërore

Në kontekst të themelimit të Byrosë Shtetërore si Agjenci e Pavarur, Aktgjykimi vë theks në parimet kushtetuese që ndërlidhen me formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve, siç janë shtjelluar përmes praktikës së saj gjyqësore ndër vite, duke theksuar që, kontestuese në rrethanat e rastit konkret është autoriteti kompetent për mbikëqyrjen e Byrosë Shtetërore, përkatësisht nëse përmes përcaktimit të ushtrimit të funksionit të mbikëqyrjes në një Komision të Pavarur, është cenuar kompetenca mbikëqyrëse e Kuvendit lidhur me Agjencitë e Pavarura të themeluara në bazë të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës. Aktgjykimi vëren që, draftet e Ligjit të kontestuar i janë nënshtruar dy herë vlerësimit të Komisionit të Venecias dhe i cili, ndër tjerash, duke theksuar që zgjedhja dhe shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore do të mund të përfitonte nga një komision i jashtëm në nivel ekspertësh, në mënyrë që të evitohet politizimi i zgjedhjes së tij/saj në Kuvend, kishte paraqitur edhe alternativën e krijimit të një trupi pluralist drejtues të Byrosë Shtetërore, të përbërë nga përfaqësues të institucioneve të pavarura, ndërsa përmes opinionit të dytë, përcaktimin e kompetencës mbikëqyrëse në raport me Byrosë Shtetërore në një Komision të pavarur Mbikëqyrës e kishte vlerësuar si një zgjidhje “të përshtatshme”. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, kompetenca mbikëqyrëse e Kuvendit në raport me institucionet publike është e rregulluar me Kushtetutë dhe, në kontekst të mbikëqyrjes së Byrosë Shtetërore relevante është ndërveprimi i neneve 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

Në kontekstin e lartcekur, Aktgjykimi sqaron që (i) bazuar në nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, Agjencitë e Pavarura janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe

kompetencat e tyre, ndërsa kjo dispozitë jo detyrimisht përcakton kompetencën mbikëqyrëse të Kuvendit në raport me këto agjenci; ndërsa (ii) bazuar në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, Kuvendi mbikëqyr ato institucione publike që bazuar në Kushtetutë dhe ligje i raportojnë Kuvendit. Sipas sqarimeve të dhëna, përderisa, në parim, është Kuvendi ai që ushtron funksionin e mbikëqyrjes ndaj Agjencive të Pavarura, Kuvendi, sipas përcaktimeve të paragrafit 9 të nenit të lartcekur, përfshirë bazuar edhe në Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ka gjithashtu autorizimin që përmes ligjit përkatës për themelimin e Agjencisë së Pavarur, kompetencën mbikëqyrëse t'ia përcaktojë një strukturë tjetër apo një Komisioni Mbikëqyrës, siç është rasti në rrethanat e Ligjit të kontestuar. Thënë këtë, për aq sa Kuvendi vendos që kompetencën mbikëqyrëse ta përcaktojë në një autoritet tjetër, ky i fundit, duhet të jetë në përputhje me dispozitat kushtetuese, përfshirë ato që ndërlidhen me ndarjen dhe ndërveprimin e pushteteve. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim dhe të cilat do të përmbliken në vijim, përbërja e Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, në kontekst të kompetencave të tij, ngrit çështje kushtetuese që ndërlidhen, ndër tjerash, me pajtueshmërinë e funksioneve kushtetuese të anëtarëve të tij.

(b) përbërja e Komisionit Mbikëqyrës në kontekst të pajtueshmërisë së funksioneve kushtetuese të anëtarëve të tij në raport me natyrën e kompetencave të Byrosë Shtetërore

Aktgjykimi rikujton që, Komisioni i lartcekur Mbikëqyrës përbëhet nga (i) një gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, i caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, i cili është edhe kryesues i Komisionit; (ii) Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës; (iii) Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; (iv) një zëvendës i Avokatit të Popullit, i caktuar nga Avokati i Popullit; dhe (v) Drejtori i Njesisë së Inteligjencës Financiare. Kompetencat e Komisionit Mbikëqyrës, sipas Ligjit të kontestuar, janë gjithëpërfshirëse dhe përfshijnë por nuk kufizohen në (i) mbikëqyrjen e punës dhe të gjithë veprimtarinë e Byrosë; (ii) propozimin e emërimit dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm, përfshirë kompetencën e zgjedhjes së tij/saj; (iii) shqyrtimin e raporteve dhe vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kompetencave të tij/saj; dhe (iv) miratimin e akteve nënligjore.

Aktgjykimi më tej sqaron që, zëvendës Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm dhe gjyqtari, janë kategori kushtetuese dhe funksionet, kompetencat,

përfshirë papajtueshmëria e funksioneve të tyre, janë të përcaktuara me Kushtetutë, përfshirë ligjet e aplikueshme për secilën kategori të lartcekur. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim dhe në analizën e kompetencave kushtetuese të Avokatit të Popullit, Auditorit të Përgjithshëm dhe gjyqtarit, në raport me natyrën e kompetencave që u përcaktohen të njëjtëve në ushtrimin e funksioneve si anëtarë të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, përfshirë në kontekst të parimeve që burojnë nga opinionet relevante të Komisionit të Venecias dhe Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë të Këshillit të Evropës, Gjykata ka vlerësuar që ushtrimi i kompetencave në cilësi të anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, për zëvendës Avokatin e Popullit, Auditorin e Përgjithshëm dhe gjyqtarin e Gjykatës Supreme, është i papajtueshëm me funksionet dhe kompetencat e tyre siç janë përcaktuar në dispozitat respektive të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Më saktësisht, sa i përket Avokatit të Popullit, përkatësisht zëvendësit të tij/saj, Aktgjykimi shtjellon funksionet kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit, përfshirë sipas praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore, me theks, në kompetencën mbikëqyrëse që ka ky institucion lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, përfshirë vet Byronë Shtetërore, sipas përcaktimeve të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës. Aktgjykimi gjithashtu sqaron rolin e zëvendës Avokatit të Popullit në Institucionin e Avokatit të Popullit, përfshirë faktin që bazuar në Ligjin nr.05/L-109 për Avokatin e Popullit, të njëjtit mund të i përcaktohen funksione shtesë. Thënë këtë, Aktgjykimi gjithashtu thekson që Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përkatësisht paragrafi 3 i nenit 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] të saj, trajton në mënyrë specifike dhe identike papajtueshmërinë e funksioneve të Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij/saj, duke përcaktuar, ndër tjerash, që të njëjtit nuk mund të ushtrorjnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale.

Sipas sqarimeve të dhëna, përfshirja e zëvendës Avokatit të Popullit në cilësinë e anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, përkatësisht roli vendimmarrës dhe mbikëqyrës në një institucion shtetëror që, ndër tjerash, do të jetë përgjegjës për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme dhe propozimin për konfiskimin e saj në procedurë civile, e cila, përfshirë sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ngrit çështje thelbësore kushtetuese në balancimin në mes interesit publik dhe të drejtave dhe lirive



themelore, ngrit çështje serioze të pajtueshmërisë me mandatin kushtetues të Avokatit të Popullit për të mbikëqyrur dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, përfshirë të vet Byrosë Shtetërore. Në fakt, ushtrimi i kompetencës mbikëqyrëse të Avokatit të Popullit sipas përcaktimeve të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, do të përfshinte një autoritet publik, vendimmarrja e të cilit është bërë me pjesëmarrjen e vet Avokatit të Popullit, përkatësisht zëvendësit të tij/saj.

Për pasojë dhe duke marrë parasysh (i) kompetencën mbikëqyrëse të Avokatit të Popullit në raport me të gjitha autoritetet publike në kontekst të të drejtave dhe lirive themelore; dhe (ii) natyrën e kompetencave të anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, në vlerësimin e Gjykatës, pjesëmarrja e zëvendës Avokatit të Popullit në një Komision Mbikëqyrës, me kompetenca gjithëpërfshirëse vendimmarrëse në raport me Byronë Shtetërore, do të cenonte pavarësinë kushtetuese të Avokatit të Popullit për të mbikëqyrur Byronë Shtetërore në kontekst të kompetencës specifike kushtetuese në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

Më tej dhe në kontekst të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi shtjellon funksionet kushtetuese dhe ligjore të Auditorit të Përgjithshëm, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Kosovës, sipas përcaktimeve të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] të Kushtetutës, si dhe kompetencën për të kontrolluar veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe përdorimin e mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal, sipas përcaktimeve të nenit 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës. Sipas sqarimeve të dhëna, kompetenca e Auditorit të Përgjithshëm për të kontrolluar veprimtarinë e autoriteteve publike dhe përdorimin e fondeve publike nga to, nuk varet nga përcaktimet e ligjeve dhe as përbërja e trupave vendimmarrëse, sepse është çështje që është e rregulluar në nivel të Kushtetutës dhe e cila, aplikohet për të gjitha autoritetet publike në Republikën e Kosovës, pa përjashtim, dhe rrjedhimisht e përfshin edhe vet Byronë Shtetërore.

Në këtë kontekst, Aktgjykimi thekson që vendimmarrja e Auditorit të Përgjithshëm në cilësinë e anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës ndërlidhur me çështjet buxhetore të Byrosë, do të cenonte detyrën kushtetuese të Auditorit të Përgjithshëm për të kontrolluar veprimtarinë ekonomike të Byrosë

Shtetërore, siç është përcaktuar në nenin 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës. Aktgjykimi rikujton që, është pikërisht roli i Auditorit të Përgjithshëm si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Kosovës, që ka rezultuar edhe në dispozitat e saktësuara me Ligjin e aplikueshëm për Auditorin e Përgjithshëm, sipas të cilit, Auditori i Përgjithshëm dhe punonjësit e tij, nuk mund të mbajnë asnjë funksion tjetër në cilindo nivel të sektorit publik.

Për pasojë dhe duke marrë parasysh (i) kompetencën mbikëqyrëse të Auditorit të Përgjithshëm në raport me të gjitha autoritetet publike në kontekst kontrollit ekonomik dhe financiar; dhe (ii) natyrën e kompetencave të anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, përfshirë faktin që të njëjtit gjithashtu bëjnë vlerësimin e performancës së Drejtorit të Përgjithshëm, shqyrtimin e raporteve të tij/saj të punës, përfshirë në kontekst të menaxhimit të buxhetit të Byrosë, në vlerësimin e Gjykatës, pjesëmarrja e Auditorit të Përgjithshëm në një Komision Mbikëqyrës, me kompetenca gjithëpërfshirëse vendimmarrëse, përfshirë ndërlidhur me menaxhimin financiar, do të cenonte pavarësinë kushtetuese të Auditorit të Përgjithshëm për të mbikëqyrur Byronë Shtetërore në kontekst të menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike sipas përcaktimeve të neneve 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] dhe 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës.

Në fund dhe ndërlidhur me gjyqtarin e Gjykatës Supreme, në cilësinë e Kryesuesit të Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore, Aktgjykimi rikujton parimet që burojnë nga Kushtetuta në kontekst të ndarjes dhe ndërveprimit të pushteteve, siç janë shtjelluar përmes praktikës së saj gjyqësore ndër vite, përfshirë papajtueshmërinë e funksioneve të gjyqtarëve me funksione tjera shtetërore. Për qëllime të kësaj analize, Aktgjykimi gjithashtu shtjellon, ndër tjerash, (i) parimet dhe standardet ndërkombëtare që ndërlidhen me pavarësinë dhe paanshmërinë e funksionit të gjyqtarit dhe papajtueshmërinë e ushtrimit të funksioneve tjera jashtë sistemit gjyqësor, duke përfshirë Parimet Bangalore të miratuara në nivel të Kombeve të Bashkuara, rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, opinionet e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias; (ii) analizën krahasuese të Kushtetutave në kontekst të rregullimit të papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit me funksione tjera shtetërore; dhe (iii) praktikën gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese ndërlidhur me interpretimin e papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit.

Aktgjykimi, ndër tjerash, thekson që Kushtetuta e Republikës përcakton ushtrimin e funksioneve shtetërore shtesë për gjyqtarët e Republikës së Kosovës, në dy raste, përkatësisht funksionet (i) në Këshillin Gjyqësor të Kosovës; dhe (ii) Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në të gjitha rastet tjera, në nenin 106 [Papajtueshmëria] të saj, Kushtetuta saktëson që (i) gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore “jashtë gjyqësorit”, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj; dhe (ii) gjyqtarëve nuk u lejohet të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së rolit të gjyqtarit. Sipas sqarimeve të dhëna, përderisa dispozita e lartcekur përcakton mundësinë e funksioneve shtesë për gjyqtarët e Republikës së Kosovës, sipas përcaktimeve të ligjeve të veçanta dhe/ose procedurave të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Kushtetuta përcakton ndalesë të qartë për gjyqtarët që të ushtrojnë ndonjë funksion në institucionet shtetërore “jashtë gjyqësorit”. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, një formulim i tillë në Kushtetutë, ndërthet detyrimin e vlerësimit të pajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit me funksionin e kryesimit të Komisionit Mbikëqyrës të një agjencie të pavarur, përkatësisht Byrosë Shtetërore, përfshirë në kontekst të kompetencave të këtij Komisioni dhe faktit nëse Byroja Shtetërore mund të vlerësohet si institucion shtetëror brenda gjyqësorit për qëllime të pajtueshmërisë së funksioneve.

Sipas sqarimeve të dhëna dhe duke marrë parasysh, (i) natyrën institucionale të Byrosë Shtetërore dhe raportin e Byrosë me gjykatat, përkatësisht pushtetin gjyqësor; dhe (ii) natyrën e kompetencave gjithëpërfshirëse që ushtron kryesuesi i Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë, përkatësisht gjyqtari i Gjykatës Supreme; dhe (iii) faktin që Byroja Shtetërore nuk mund të cilësohet si institucion shtetëror brenda gjyqësorit për qëllime të formulimit të nenit 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës, ndër tjerash, sepse raporti në mes Byrosë Shtetërore dhe pushtetit gjyqësor, sipas Ligjit të kontestuar, është i natyrës mbikëqyrëse, përkatësisht vendimmarrja e Byrosë Shtetërore në kontekst të verifikimit dhe propozimit për konfiskimin e pasurisë i nënshtrohet gjithnjë kontrollit dhe vendimmarrjes së pushtetit gjyqësor, në vlerësimin e Gjykatës, funksioni i gjyqtarit të Republikës së Kosovës nuk është i pajtueshëm me udhëheqjen e Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore sipas përcaktimeve të nenit 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës.

Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, në adresimin e çështjeve si më sipër, Kuvendi, përmes ndryshimeve dhe/ose plotësimeve të dispozitave të lartcekura, për aq sa përcaktohet që të mos ushtrojë funksionin mbikëqyrës vet, duhet të përcaktojë përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës të Byrosë Shtetërore në atë mënyrë, që respektohen të gjitha garancitë e nevojshme për pavarësinë e këtij institucioni, duke mos cenuar në të njëjtën kohë dispozitat kushtetuese që ndërliken me papajtueshmërinë e funksioneve dhe/ose kompetencat mbikëqyrëse të institucioneve të pavarura kushtetuese.

(c) mënyra e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore

Aktgjykimi gjithashtu shtjellon mënyrën e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore, i cili, sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar, zgjedhet nga Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, por që, nëse Kuvendi nuk arrin që të zgjedh Drejtorin në dy raunde votimi, pas dy konkurseve, kompetenca për të zgjedhur Drejtorin e Përgjithshëm i kalon Komisionit Mbikëqyrës. Një rregullim i tillë, sipas sqarimeve të dhëna, në parim, ngrit dy çështje kontestuese, përkatësisht (i) zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm nga Kuvendi vetëm me shumicë të thjeshtë; dhe (ii) mekanizmin de-blokues të kalimit të kësaj kompetence në Komisionin Mbikëqyrës, në rast dështimi të zgjedhjes në Kuvend.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë në Kuvend, nuk është në kundërshtim me përcaktimet e neneve 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës. Thënë këtë dhe marrë parasysh rëndësinë e funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore, përfshirë mandatin shtatë (7) vjeçar të tij/saj, Aktgjykimi gjithashtu rikujton rekomandimin e vazhdueshëm të Komisionit të Venecias në opinionet e tij për Kosovën, por edhe opinionet tjera relevante në kontekst të zgjedhjes së strukturave udhëheqëse të agjencive/komisioneve përgjegjëse për konfiskimin civil të pasurisë, që zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm të jetë me shumicën prej dy të tretave (2/3) të deputetëve. Në anën tjetër dhe lidhur me mekanizmin e zgjedhur de-blokues, përkatësisht kalimin e kompetencës së zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm në Komisionin Mbikëqyrës, Aktgjykimi sqaron që, mënyra e zgjedhjes së titullarëve/anëtarëve të Agjencive të Pavarura nuk është e saktësuar me dispozita kushtetuese dhe për pasojë, përcaktimi i mënyrës së zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë Shtetërore, bazuar në

paragrafin 1 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, është në kompetencë të Kuvendit, duke rikujtuar gjithashtu që për aq sa nuk janë cenuar normat kushtetuese, vlerësimi i përzgjedhjes së politikës publike që ka dërguar deri tek miratimi i një ligji/dispozite të caktuar, nuk është në kompetencën e Gjykatës.

Në fund, Aktgjykimi sqaron që kërkesa e parashtruesve të kërkesës është parashtruar në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe se kjo kategori e kërkesave ka karakter suspenziv, përkatësisht ligji i tillë, mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje vetëm pas vendimmarrjes së Gjykatës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës. Thënë këtë, dhe përkundër faktit që në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Gjykata ka vlerësuar si në kundërshtim me Kushtetutën vetëm pjesë të saktësuarra të katër (4) neneve të Ligjit të kontestuar, përkatësisht nenet 2 (Fushëveprimi), 10 (Përbërja e Komisionit Mbikëqyrës dhe Kompensimi), 22 (Periudha e verifikimit të pasurisë) dhe 34 (Procedura në shkallën e parë) të tij, marrë parasysh natyrën dhe rëndësinë e tyre, dhe faktin që pa ndryshimin dhe plotësimin e të njëjtave nga Kuvendi, Ligji i kontestuar është i pazbatueshëm, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, Ligji i kontestuar, në shërbim të parimit të sigurisë juridike, është shpallur i pavlefshëm në tërësinë e tij.



Aktgjykim

KO158/23

Parashtrues

Besnik Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të ardhurat Personale Vjetore

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vendosur lidhur me kërkesën në rastin KO158/23, të parashtruar nga Besnik Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në përcaktimet e paragrafit 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr.08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore.

Gjykata, ka vendosur (i) njëzëri, që të deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) njëzëri, që të konstatojë që neni 2 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-141) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (ii) me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, që neni 3 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr.04/L-092 për Personat e Verbër) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) njëzëri, që neni 4 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iv) me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, që të konstatojë që neni 6 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr.03/L-212 të Punës) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe (v) njëzëri, të shpallë, që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji nr.08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje.

Aktgjykimi fillimisht sqaron që, Ligji i kontestuar ndryshon dhe plotëson (i) Ligjin nr.04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i

ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-141; (ii) Ligjin nr. 04/L-092 për Personat e Verbër; (iii) Ligjin nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik; (iv) Ligjin nr.05/L-028 për Tatim në të Ardhura Personale; dhe (v) Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Në thelb, Ligji i kontestuar ndryshon dhe plotëson ligjet e lartcekura në dy aspekte relevante.

Së pari, ndryshon mënyrën e përcaktimit të lartësisë së pensioneëve dhe kompensimeve, përfshirë ndërlihdjen e kësaj lartësie me pagën minimale, për veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, duke saktësuar që, për dallim nga rregullimet aktuale, sipas të cilave lartësia e pensioneëve dhe/ose kompensimeve përkatëse është e ndërlihdhur me lartësinë ose një shkallë të lartësisë së pagës minimale në Republikën e Kosovës, lartësinë e këtyre pensioneëve dhe/ose kompensimeve, e përcakton Qeveria, me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Financa, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual. Së dyti, ndryshon mënyrën e përcaktimit të lartësisë së pagës minimale në Republikën e Kosovës, duke saktësuar që, për dallim nga rregullimet aktuale sipas të cilave në fund të çdo viti kalendarik, Qeveria e përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomik-Social, në mungesë të propozimit nga ky i fundit, është vet Qeveria që përcakton lartësinë e pagës minimale. Aktgjykimi më tej sqaron që Ligji i kontestuar nuk afekton të drejtën e kategorive të lartcekura për pensione dhe kompensime dhe as nuk përcakton lartësinë e tyre.

Deputetët parashtrues të Kuvendit kontestojnë Ligjin e lartcekur duke pretenduar që i njëjti është në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, në esencë, sepse: (i) ndryshimi i mënyrës së përcaktimit të lartësisë së pensioneëve dhe/ose kompensimeve duke e larguar referencën në nivelin e pagës minimale, rezulton në cenim të parimit të barazisë para ligjit në mes të kategorisë së veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, sepse duke lënë përcaktimin e nivelit të kompensimit përkatës në diskrecionin e Qeverisë, këto kategori nuk kanë garanci që do të kompensohen në mënyrë të barabartë; (ii) largimi i referencës në nivelin e pagës minimale lidhur me përcaktimin e lartësisë së pensioneëve dhe/ose kompensimeve përkatëse, cenon pritjet legjitime të kategorive të lartcekura dhe për pasojë, të drejtën në pronë të veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik; dhe (iii) mundësia e Qeverisë që në mungesë të propozimit të Këshilli Ekonomik-Social, të

përcaktojë vet pagën minimale, nuk është në përputhje me vlerat kushtetuese të drejtësisë sociale dhe të cilat, duhet të interpretohen sipas parimeve të saktësuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) dhe Konventa për Caktimin e Pagës Minimale. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në parim, mbështeten edhe nga Avokati i Popullit, ndërsa kundër-argumentohen nga Ministria e Financave dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, të cilët theksojnë se Ligji i kontestuar është në përputhje me Kushtetutën, në esencë, sepse: (i) nuk është cenuar parimi i barazisë para ligjit, marrë parasysh që kategoritë e afektuara, nuk janë në “situata analoge apo relativisht të ngjashme” me njëra tjetrën dhe as me të punësuarit e Republikës së Kosovës, duke qenë se (a) veteranët e UÇK-së, marrin pensionin dhe beneficinet tjera për shkak të shërbimit të tyre në luftë dhe si shenjë mirënjohjeje e shtetit ndaj tyre; (b) personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, përfitojnë të drejta dhe beneficione për shkak të karakteristikave të tyre personale; ndërsa (c) të punësuarit, paguhen për punën dhe shërbimin e tyre nga sektori publik ose privat dhe, për pasojë, koncepti i pagës minimale vlen vetëm për këta të fundit; (ii) nuk janë cenuar pritjet legjitime dhe për pasojë, të drejtat pronësore të kategorive të lartcekura, duke marrë parasysh që lartësia e pensionit dhe/ose kompensimeve përkatëse nuk është zvogëluar, ndërsa largimi i referencës në nivelin e pagës minimale, ndërlihdhet me nevojën për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare dhe fleksibilitetin e nevojshëm për të ndryshuar nivelin e pagës minimale, duke mbajtur qëndrimin gjithashtu që, Qeveritë gëzojnë diskrecion të gjerë në përcaktimin e politikave sociale dhe lartësitë e pensioneëve; dhe (iii) mënyra e përcaktimit të pagës minimale, nuk është çështje kushtetuese, ndërsa standardet e ONP-së nuk janë të aplikueshme, sepse Republika e Kosovës nuk është anëtare e saj, por se edhe po të aplikoheshin ato standarde, të njëjtat ngërthejnë vetëm detyrimin e konsultimit, i cili nuk është afektuar përmes Ligjit të kontestuar.

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Aktgjykimi fillimisht dhe ndër tjerash, shtjellon (i) parimet themelore kushtetuese lidhur me drejtësinë sociale, siç janë të saktësuar në nenet 7 [Vlerat] dhe 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, përfshirë statusin e Konventës për Caktimin e Pagës Minimale të ONP-së, Kartës Sociale Evropiane dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara; (ii) parimet themelore që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me barazinë para ligjit dhe të drejtat pronësore, përfshirë në kontekst të lartësisë së

kompensimeve që ndërlihen me beneficionet sociale; dhe (iii) historikun e ligjeve të aplikueshme që ndërlihen me pensionet, kompensimet dhe beneficionet e veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

Në aplikimin e parimeve të lartcekura, Aktgjykimi fillimisht thekson që (i) bazuar në nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet, ndër tjerash, në parimet e demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës dhe drejtësisë sociale; (ii) bazuar në nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të, ndër tjerash, statusit social; ndërsa (iii) bazuar në nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj. Aktgjykimi, duke u referuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjithashtu vë theks në faktin që shtetet, në parim, kanë diskrecion në përcaktimin e politikave sociale, përfshirë natyrën dhe lartësinë e beneficioneve dhe/ose kompensimeve për kategori të ndryshme sociale, gjithnjë nën detyrimin e trajtimit të barabartë dhe proporcional të këtyre kategorive, përfshirë në kontekst të pritjeve përkatëse legjitime për kompensim dhe/ose mbështetje nga shteti.

Në Aktgjykimin e Gjykatës, parimet e sqaruara si më sipër, janë aplikuar në shqyrtimin e secilit nen të vlerësuar të Ligjit të kontestuar veç e veç. Thënë këtë dhe për qëllime të kësaj përmbledhjeje, Gjykata do të sqarojë të gjeturat dhe konstatimet kryesore përkitazi me çështjet më kontestuese të Ligjit të kontestuar, përkatësisht nëse si rezultat i eliminimit të ndërlihdjes së lartësisë të pensioneve dhe/ose kompensimeve me nivelin e pagës minimale ose një shkallë të lartësisë së pagës minimale në Republikën e Kosovës, (i) është cenuar parimi i barazisë para ligjit në mes veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik; (ii) nëse janë cenuar të drejtat pronësore të veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe paraplegjik dhe tetraplegjik; dhe (iii) nëse janë cenuar parimet e drejtësisë sociale si rezultat i ndryshimit të mënyrës së përcaktimit të lartësisë së pagës minimale në Republikën e Kosovës. Në vijim, do të reflektohen konstatimet më thelbësore të Aktgjykimit, lidhur me tri çështjet e lartcekura.

- *barazia para ligjit në kontekst të lartësisë së pensioneve dhe/ose kompensimeve lidhur me veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik*

Në vlerësimin nëse Ligji i kontestuar cenon parimin e

barazisë para ligjit, Aktgjykimi, në kontekst të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rithekson që, në parim, për të konstatuar cenimin e parimit të barazisë para ligjit sipas përcaktimeve të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, duhet fillimisht të vlerësohet nëse kategoritë diskriminimi i të cilave pretendohet, janë në “situata analoge ose relativisht të ngjashme” dhe nëse ky është rasti, nëse ka një “dallim në trajtim” në mes tyre.

Në kontekst të analizës së lartcekur, Aktgjykimi, ndër tjerash, vë theks në ligjet e aplikueshme për veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik dhe të punësuarit në sektorin publik dhe privat, duke theksuar qëllimet, detyrimet, por edhe të drejtat dhe beneficionet, përfshirë dallimet në mes tyre. Aktgjykimi, ndër tjerash, sqaron (i) dallimin në mes të fushëveprimit të Ligjit të Punës, përfshirë sa i përket të drejtave dhe detyrimeve për të punësuarit në sektorin publik dhe privat, me fushëveprimin e ligjeve që ndërlihen me veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik dhe të cilat përcaktojnë të drejta, beneficione dhe lehtësira për tri kategoritë e lartcekura; dhe (ii) dallimin në mes të fushëveprimeve të ligjeve që ndërlihen me veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, të cilat ligje, në parim, përfshijnë të drejta dhe beneficione për (a) veteranët e UÇK-së, sepse të njëjtit me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtar për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës; dhe (b) personat e verbër dhe ata paraplegjik dhe tetraplegjik, për shkak të karakteristikave të tyre personale dhe të drejtave që burojnë nga neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] i Kushtetutës.

Bazuar në sqarimet e dhëna në Aktgjykim, duke marrë parasysh dallimin e fushëveprimit të Ligjit të Punës në njërën anë dhe fushëveprimeve të ligjeve të aplikueshme për veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik në anën tjetër, përfshirë qëllimin e secilit ligj të lartcekur dhe dallimin në kontekst të detyrimeve, por edhe të drejtave, beneficioneve dhe lehtësirave për secilën kategori të lartcekur, Gjykata vlerësoi që kategoritë e lartcekura, nuk mund të konsiderohen të jenë në “situata analoge ose relativisht të ngjashme” me njëra tjetrën, dhe për pasojë, nuk mund të ketë as “dallim në trajtim” e as cenim të parimit të barazisë para ligjit në mes këtyre kategorive, në parim, sepse kategoria e veteranëve të UÇK-së, mbështetet nga shteti marrë parasysh kontributin e tyre për lirinë dhe pavarësinë e popullit të Kosovës, ndërsa kategoritë e personave të verbër dhe atyre paraplegjik dhe tetraplegjik,



mbështeten nga shteti marrë parasysh karakteristikat e tyre personale, sipas specifikave dhe përcaktimeve të dy ligjeve të aplikueshme, Ligjit për Personat e Verbër dhe Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, respektivisht. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, konstatimet e lartcekura janë të mbështetura nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në të cilën, specifikisht është trajtuar edhe “dallimi në trajtim” në kontekst të kompensimeve dhe/ose beneficioneve sociale në mes të të punësuarve në sektorin publik dhe privat, përfshirë në mes të veteranëve të luftës dhe kategorive tjera të shoqërisë që kualifikohen për të përfituar beneficione të ndryshme sociale.

Për pasojë dhe sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, Gjykata ka konstatuar që nenet 2, 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, nuk janë në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

- të drejtat pronësore të ndërlidhura me pritjet legjitime për një lartësi të caktuar të pensioneve dhe/ose beneficioneve që ndërlidhen me lartësinë ose një shkallë të lartësisë të pagës minimale në Republikën e Kosovës

Në vlerësimin nëse Ligji i kontestuar cenon të drejtat pronësore të kategorive të veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, Aktgjykimi, në kontekst të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rithekson që, bazuar në nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, koncepti i “pasurisë”, në parim, përfshinë si “pasuritë ekzistuese”, ashtu edhe pasuritë e pretenduara, gjithashtu në kontekst të “të hyrave të ardhshme”, në lidhje me të cilat, një individ mund të argumentojë se ka të paktën një “pritshmëri legjitime”. Praktika e lartcekur gjyqësore vë theks në faktin që “pensionet dhe përfitimet sociale”, përfshirë skemat jo-kontributdhënëse, gjithashtu gëzojnë mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nën kushtet dhe parimet e përcaktuara nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, këto të drejta mund të kufizohen në rrethanat në të cilat “ndërhyrja në/kufizimi” i tyre është (i) i “përcaktuar me ligj”; (ii) ndjek një “qëllim legjitim”; dhe (iii) është “proporcional” me qëllimin legjitim të ndjekur.

Aktgjykimi gjithashtu sqaron që, në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (i) shtetet gëzojnë lirinë të vendosin nëse do të kenë në funksion ndonjë formë të skemës së sigurimeve sociale ose të zgjedhin llojin ose lartësinë e

përfitimeve që mund të sigurohen sipas ndonjë skeme të tillë, por megjithatë, (ii) nëse një shtet parashih skema të sigurimeve sociale, përfshirë të drejta për përfitim të mirëqenies, qoftë nëse kushtëzohet ose jo nga pagesa paraprake e kontributeve ose jo, duhet të konsiderohet se nga ai legjislacion buron një interes pronësor, i cili pastaj bie brenda fushëveprimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, (iii) të drejtat që ndërlidhen me skemat pensionale, mund të kufizohen për qëllime legjitime, të cilat, në parim, përfshijnë edhe rrezikun e dëmtimit të ekuilibrit financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore, me kushtin që kufizimet e tilla të jenë proporcionale.

Sipas sqarimeve të dhëna, kontestuese në rrethanat e Ligjit të kontestuar është nëse duke eliminuar referencën në nivelin e lartësisë së pagës minimale ose një shkallë të saj, Ligji i kontestuar, ka rezultuar në cenimin e të drejtave pronësore për: (a) veteranët e UÇK-së; (b) personat e verbër; dhe (c) personat paraplegjik dhe tetraplegjik. Konstatimet e Gjykatës lidhur me këto pretendime do të përmbliidhen në vijim.

(a) lidhur me veteranët e UÇK-së

Në kontekst të kategorisë së veteranëve të UÇK-së, dhe duke analizuar ndryshimet dhe plotësimet e ligjit përkatës të aplikueshëm ndër vite, Aktgjykimi sqaron që ndërlidhja e lartësisë së pensioneve të veteranëve të UÇK-së me lartësinë e pagës minimale në Republikën e Kosovës, nuk është ndryshuar përmes Ligjit të kontestuar, por që në vitin 2017, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Veteranëve, përkatësisht Ligjit nr.05/L -141 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky ligj, për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, që në vitin 2017 (i) ka eliminuar nenin 18 (Lartësia e shumës së pensioneve) të ligjit bazik, përkatësisht dispozitën që ka saktësuar se varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti, për vitin e ardhshëm, Qeveria me propozimin e Ministrisë së Financave, mund të vendosë për lartësinë e shumës së pensionit të veteranit të UÇK-së, me kushtin që ky pension “nuk mund të jetë më i vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë”; ndërsa, (ii) i ka shtuar ligjit bazik nenin 16A (pa titull), i cili ndër tjerash, ka përcaktuar kategorizimin e veteranit të UÇK-së në përputhje me kohën e mobilizimit dhe shërbimit në UÇK, duke saktësuar lartësinë e pensionit mujor për secilën kategori dhe duke e kufizuar lartësinë e përgjithshme të pagesave për pensionet e veteranëve të UÇK-së në kufirin e 0.7% (zero pikë shtatë përqind) të Bruto Prodhimit Vendor



në vit. Aktgjykimi rikujton që ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Veteranët të vitit 2017, janë kontestuar para Gjykatës Kushtetuese dhe kjo e fundit, përmes Aktgjykimit në rastin KO01/17, ka trajtuar në mënyrë specifike çështjen e eliminimit të referencës, përkatësisht ndërlidhjes së lartësisë së pensioneve të veteranëve të UÇK-së me nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykimin përkatës të vitit 2017, Gjykata ka vlerësuar që përderisa eliminimi i garancive që ndërlidhen me pagën minimale për kategoritë e veteranëve të UÇK-së, përbën “ndërhyrje” në të drejtat përkatëse pronësore, kjo “ndërhyrje” kishte një qëllim legjitim dhe ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur, duke konstatuar rrjedhimisht që nuk është në kundërshtim me Kushtetutë. Për pasojë, dhe sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, pretendimet që ndërlidhen me cenimin e të drejtave pronësore të veteranëve të UÇK-së si pasojë e shkëputjes së ndërlidhjes të lartësisë së pensioneve me lartësinë e pagës minimale në Republikën e Kosovës, janë përmbyllur përmes Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO01/17.

Thënë këtë, Aktgjykimi sqaron që Ligji i kontestuar përmban një ndryshim dhe/ose plotësim shtesë, që ndërlidhet me periudhën tranzitore, përkatësisht nivelin e lartësisë së pensioneve të veteranëve të UÇK-së deri në kategorizimin përfundimtar të tyre. Më saktësisht dhe sipas sqarimeve të dhëna, (i) përderisa Ligji për Veteranët i viti 2017, kishte eliminuar garancinë e ndërlidhjes së lartësisë së pensionit me pagën minimale, i njëjti kishte mbajtur në fuqi dispozitat e ligjit bazik, përkatësisht Ligjit për Veteranët të vitit 2014, të cilat mundësonin që veteranët e UÇK-së të marrin pensionet të paktën në lartësinë e pagës minimale deri në kategorizimin përfundimtar të tyre; dhe (ii) ky përcaktim, tani ndryshohet përmes Ligjit të kontestuar, i cili përcaktimin e lartësisë së pensioneve përkatëse përgjatë kësaj periudhe tranzitore, përkatësisht deri në kategorizimin përfundimtar të veteranëve të UÇK-së, e vendos në diskrecionin e Qeverisë, kushtëzuar nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetës dhe inflacioni eventual.

Rrjedhimisht, sipas sqarimeve të dhëna, në rrethanat e Ligjit të kontestuar, nuk është kontestuese ndërlidhshmëria e lartësisë së pensioneve me pagën minimale, sepse kjo çështje është zgjidhur përmes Ligjit për Veteranët të vitit 2017, por kontestuese është nëse vonesat në zbatimin e ligjit të lartcekur, përkatësisht detyrimit të shtetit për të bërë kategorizimin përfundimtar të veteranëve, mund të rezultojnë në “pritje legjitime” për kategorinë e veteranëve të UÇK-së që deri në kategorizimin

përfundimtar të tyre, të përfitojnë pensione në lartësinë e pagës minimale në Republikën e Kosovës.

Në kontekstin e lartcekur, Aktgjykimi, ndër tjerash, thekson që bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “pritjet legjitime” për të “hyrat e ardhshme”, përfshirë në kontekst të “pensioneve dhe beneficioneve sociale”, nuk mund të burojnë thjeshtë nga vonesat në zbatimin e ligjeve, përfshirë Ligjin për Veteranët të vitit 2017 në kontekst të kategorizimit të veteranëve të UÇK-së, duke vënë theks po ashtu në faktin që bazuar në parimet e sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike, të cilat ndër tjerash, burojnë nga neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës, autoritetet publike në Republikën e Kosovës, janë të detyruara të zbatojnë ligjet e miratuara nga Kuvendi. Për më tepër, Aktgjykimi gjithashtu sqaron që (i) nuk është kontestues detyrimi i shtetit për përkrahjen financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtar për lirinë dhe çlirimin e Republikës së Kosovës; (ii) Ligji i kontestuar nuk afekton të drejtën në pension të veteranëve të UÇK-së si rezultat i kontributit të lartcekur të tyre; ndërsa (iii) Ligji i kontestuar gjithashtu nuk përcakton dhe as nuk zvogëlon lartësinë e pensioneve të kategorisë së veteranëve të UÇK-së. Thënë këtë, Aktgjykimi më tej thekson që bazuar në garancitë që burojnë nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zbritja eventuale e nivelit të lartësisë së të “hyrave të ardhshme”, përfshirë në kontekst të “pensioneve dhe beneficioneve sociale”, mund të rezultojë në “ndërhyrje” në të drejtën në pronë, dhe si i tillë, mund të kontestohet dhe t’i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë dhe/ose kushtetutshmërisë, në kontekst të ndërhyrjes në këto të drejta dhe proporcionalitetit të kësaj ndërhyrjeje në raport me qëllimin legjitim të ndjekur.

Për pasojë dhe sipas sqarimeve në Aktgjykim, Gjykata ka konstatuar që neni 2 i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

(b) lidhur me personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik

Në kontekst të kategorive të personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, dhe duke analizuar ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve përkatëse të aplikueshme ndër vite, Aktgjykimi sqaron që për dallim nga Ligji për Veteranët i vitit 2017, Ligji për Personat e Verbër dhe Ligji për Personat



Paraplegjik dhe Tetraplegjik, nuk garantojnë lartësinë e kompensimit të paktën në nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës, por “në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale” që përcaktohet nga Qeveria. Për më tepër, ligjet e lartcekura, gjithashtu dallojnë edhe në mes vete sa i përket garancive lidhur me lartësinë e kompensimeve. Ligji për Personat e Verbër ngërthen një garanci shtesë dhe sipas të cilës, personat e verbër marrin nga buxheti shtetëror kompensim në “një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale”, por jo më pak se njëqind (100) euro në muaj. Ndërkaq, Ligji për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, vë theks edhe në diskrecionin e shtetit për të ndryshuar lartësinë e kompensimit, përfshirë për të zvogëluar dhe eliminuar të njëjtën, varësisht nga disponueshmëria e fondeve dhe rrethanat që krijojnë tendosje të paparapara fiskale në buxhetin publik. Ligji i kontestuar, ndryshon dhe plotëson ligjet bazike të lartcekura, duke përcaktuar mekanizmin e njëjtë për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për të dy kategoritë, përkatësisht që Qeveria, me propozimin e Ministrisë së Financave, të vendosë për lartësinë e shumës së kompensimeve për personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetës dhe inflacioni eventual.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, në kontekst të ligjeve të aplikueshme për personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, (i) nuk është kontestuese e drejta e personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik për mbështetje financiare dhe/ose kompensim, sepse kjo e drejtë buron nga neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] i Kushtetutës dhe ligjet e aplikueshme dhe nuk afektohet përmes Ligjit të kontestuar, por (ii) kontestuese është nëse lartësia e kompensimit, e cila nuk është e saktësuar në ligjet e aplikueshme dhe as në Ligjin e kontestuar, mund të ngritë “pritje legjitime” në lidhje me të “hyrat e ardhshme” të personave të verbër dhe atyre paraplegjik dhe tetraplegjik për qëllime të garancive që ngërthen neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në rrethana të tilla dhe marrë parasysh që nuk është kontestuese e drejta në kompensim mujor, por lartësia e këtij kompensimi dhe e cila jodetyrimisht zvogëlohet përmes Ligjit të kontestuar, nuk mund të konstatohet të jenë cenuar të drejtat pronësore të këtyre kategorive.

Për pasojë dhe sipas sqarimeve në Aktgjykim, Gjykata ka konstatuar që nenet 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, nuk janë në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat

e Njeriut. Thënë këtë dhe duke e theksuar kompetencën e Kuvendit për të përcaktuar politikat sociale të Republikës së Kosovës, gjithnjë në përputhje me vlerat e Kushtetutës ndërlidhur me drejtësinë sociale dhe të drejtat dhe liritë themelore, Aktgjykimi vë theks në (i) nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, i cili, ndër tjerash, garanton sigurimin social themelor që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë në mënyrë e rregulluar me ligj; (ii) nenin 28 (Standardet e duhura të jetesës dhe mbrojtjes sociale) të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës, shtetet janë të detyruara që të njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për një standard adekuat jetese për ta dhe për familjet e tyre, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e përshtatshëm, si edhe të drejtën për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe zotohen të ndërmarrin hapat e duhura për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar; dhe (iii) praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilës personat me aftësi të kufizuara janë të identifikuar si kategori e cila është e margjinalizuar, dhe që historikisht i është nënshtruar diskriminimit dhe paragjyqimeve, gjë që ka sjellë izolimin e tyre në shoqëri. Marrë parasysh këto parime, dhe faktin që shkalla e vlerësimit të shteteve në kufizimin e të drejtave të kësaj kategorie, është substancialisht më e kufizuar, Aktgjykimi thekson që Kuvendi dhe/ose Qeveria duhet të kenë arsye shumë serioze për të ndërhyrë në këto të drejta, përfshirë në kontekst të mundësisë së zvogëlimit të lartësisë së kompensimeve përkatëse. Thënë këtë dhe duke marrë parasysh faktin që Ligji i kontestuar nuk e afekton të drejtën për kompensim të kategorive të lartcekura dhe as nuk përcakton dhe/ose zvogëlon lartësinë e tij, Aktgjykimi megjithatë thekson që zbritja eventuale e lartësisë të “të hyrave të ardhshme”, përfshirë në kontekst të “pensioneve dhe beneficioneve sociale”, duhet të jetë gjithnjë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe në këtë kontekst, mund të kontestohet dhe t’i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë dhe/ose kushtetutshmërisë, përkatësisht përputhshmërisë me të drejtat dhe liritë themelore të personave të verbër dhe atyre paraplegjik dhe tetraplegjik.

- *mënyra e përcaktimit të lartësisë së pagës minimale*

Në kontekst të mekanizmave që përcaktojnë lartësinë e pagës minimale në Republikën e Kosovës, Aktgjykimi fillimisht sqaron që neni 57 (Paga minimale) i Ligjit të Punës, ndër tjerash, saktëson që

Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomik-Social, ndërsa Ligji i kontestuar, e ndryshon dhe plotëson nenin e lartcekur, duke e mbajtur detyrimin e Qeverisë që të përcaktojë pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomik-Social, por duke e shtuar mundësinë që vet Qeveria të përcaktojë pagën minimale në rast se mungon një propozim i tillë.

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit të lartcekur, Aktgjykimi rithekson që, përtej drejtësisë sociale si vlerë e Republikës së Kosovës, çështjet që ndërlidhen me mekanizmat që përcaktojnë pagën minimale, janë të rregulluara në nivel ligji dhe akti nënligjor, përkatësisht me Udhëzimin Administrativ nr. 09/2017 për Caktimin e Pagës Minimale në Republikën e Kosovës. Për më tepër, sipas sqarimeve të dhëna, përderisa Konventa e ONP-së për Caktimin e Pagës Minimale nuk është drejtpërdrejt e zbatueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës, megjithatë parimet që burojnë nga e njëjta, janë të reflektuara, në parim, në Ligjin e aplikueshëm për Punën. Sipas standardeve të Konventës së lartcekur, përcaktimi i pagës minimale është një nga mekanizmat që shtetet duhet ta përdorin për të përmbushur drejtësinë sociale dhe qëllimi i caktimit të pagës minimale, duhet të jetë mbrojtja e punëtorëve të cilët kanë paga shumë të ulëta, që atyre t'ju ofrohen kushte për një jetë të dinjitetshme dhe që niveli i kësaj page duhet të caktohet pas marrëveshjes ose konsultimit të plotë me përfaqësuesit e punëtorëve dhe punëdhënësve.

Aktgjykimi tutje sqaron që, përderisa neni 6 i Ligjit të kontestuar, e largon kushtin që Këshilli Ekonomik-Social të jetë vendimtar në përcaktimin e pagës minimale, i njëjti jodetyrimisht e afekton detyrimin e konsultimit të plotë me organizatat që përfaqësojnë të punësuarit dhe punëmarrësit në kuadër të Këshillit Ekonomik-Social, sepse ky i fundit gjithnjë ka rolin primar në vendosjen përkritazi me propozimin e përcaktimit të pagës minimale në Republikën e Kosovës dhe vetëm në rast të dështimit të arritjes së këtij konsensusi, kompetenca vendimmarrëse brenda një viti kalendarik, kalon në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Sipas sqarimeve të dhëna, Gjykata vëren që, ndryshimi i mënyrës së përcaktimit të pagës minimale në raport me përbërjen dhe mënyrën e vendimmarrjes së Këshillit Ekonomik-Social, mund të afektojë mënyrën e konsultimit dhe/ose të vendimmarrjes në mes të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve, punëtorëve dhe Qeverisë, në kontekst të propozimit për nivelin e pagës minimale, por që megjithatë, nuk është në kompetencën e Gjykatës që të vlerësojë përzgjedhjen e politikës publike nga përfaqësuesit e popullit, por vetëm të vlerësojë nëse janë cenuar

dispozitat e Kushtetutës. Siç është sqaruar më lart, kjo e fundit nuk ngërthen norma që e rregullojnë çështjen e mekanizmave të nevojshëm për përcaktimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës.

Në rrethana të tilla dhe sipas sqarimeve të dhëna, Gjykata ka konstatuar që neni 6 i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës.



Aktgjykim

KO15/24

Parashtrues

Institucioni i Avokatit të Popullit

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nenit 28 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka vendosur në rastin KO15/24 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të parashtruar nga Avokati i Popullit, bazuar në përcaktimet e nënparagrafit 1 të paragrafit 2 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata, (i) me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, ka vendosur që të deklarojë kërkesën e pranueshme; ndërsa (ii) njëzëri, që të konstatoj që neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk është në kundërshtim me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Aktgjykimi, fillimisht sqaron që, thelbi i çështjes së ngritur para Gjykatës, ndërlidhet me nenin 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe i cili përcakton që (i) në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) përqind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) përqind janë femra, me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së



paku një herë në secilin grup prej tre (3) kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë; (ii) kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë; dhe (iii) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndanë fonde publike shtesë, në vlerën një përqind (1%) të shumës së përgjithshme të alokuar për subjektin politik, për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën tridhjetë përqind (30%) në momentin e certifikimit dhe që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve planifikon pas çdo palë zgjedhje buxhet shtesë për këtë qëllim.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, Avokati i Popullit konteston kushtetutshmërinë e nenit të lartcekur të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me pretendimin që i njëjti është në kundërshtim me parimet dhe vlerat e përcaktuara në nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, duke ngritur, ndër tjerash, pretendimet specifike si në vijim (i) vendosja me ligj e kuotës prej tridhjetë përqind (30%) për secilën gjini, përbën paragjykim të pajustificuar dhe për ligj trajtimin e pabarabartë, duke marrë parasysh se përqindja gjinore është pothuajse pesëdhjetë përqind (50%) me pesëdhjetë përqind (50%) mes “meshkujve dhe femrave”; (ii) në praktikën zgjedhore “nuk ka ngjarë që subjektet politike të kenë dërguar për certifikim listat e kandidatëve me nga pesëdhjetë përqind (50%) meshkuj dhe femra”; dhe (iii) ky përcaktim, po ashtu është në kundërshtim me frymën e barazisë gjinore të parashikuar me nenin 5 (Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore) të Ligjit nr.05/L-020 për Barazi Gjinore. Pretendimet e Avokatit të Popullit, kundër-argumentohen nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, i cili, ndër tjerash, dhe duke u referuar në praktikën paraprake gjyqësore të Gjykatës, thekson që neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, është në përputhje me Kushtetutën, në esencë, sepse (i) kuota prej tridhjetë përqind (30%) në listat zgjedhore është kuotë ligjore, ndërsa përcaktimet e Ligjit për Barazinë Gjinore janë ideale ligjore dhe kushtetuese; dhe (ii) neni i lartcekur nuk përbën diskriminim të tërthortë, marrë parasysh se ky prag minimal është masë afirmative me qëllim të ruajtjes së ekuilibrit gjinor në politikë.

Në kontekstin e lartcekur, Aktgjykimi thekson që thelbi i çështjes së ngritur para Gjykatës, është përputhshmëria me Kushtetutën e nenit 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, përkatësisht vlerësimi nëse përcaktimi i kuotës ligjore prej së paku tridhjetë përqind (30%) të përfaqësimit të secilës gjini në listën e subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, cenon të drejtat zgjedhore të përcaktuara

me Kushtetutë. Në këtë aspekt, Aktgjykimi, fillimisht vë theks në faktin që barazia gjinore është një ndër vlerat më thelbësore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe që autoritetet publike të Republikës e në veçanti, Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka detyrimin pozitiv që, në ushtrimin e kompetencës ligjberëse, të ndërmerret të gjitha masat e nevojshme drejt realizimit të domosdoshëm të barazisë gjinore në Republikën e Kosovës. Ndërlidhur me të drejtat zgjedhore dhe të cilat ngërthejnë thelbin e këtij Aktgjykimi, ky i fundit, rikujton që neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] i Kushtetutës, ndër tjerash, përcakton që çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Kjo e drejtë kushtetuese, duhet gjithashtu të vlerësohet në dritën e vlerave e parimeve kushtetuese, sipas të cilave Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore. Për më tepër, Aktgjykimi thekson që bazuar në përcaktimet kushtetuese, përkundër që të gjithë janë të barabartë para ligjit, parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë dhe masat e tilla zbatohen, vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, përderisa Kushtetuta përcakton që parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë, duke mundësuar, ndër tjerash, vendosjen e kuotave ligjore për pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të gjinive në jetën politike deri atëherë kur të jetë arritur barazia e domosdoshme, Kushtetuta nuk përcakton lartësinë, përkatësisht përqindjen e kësaj kuote ligjore, duke e deleguar këtë çështje në kompetencën e Kuvendit të Republikës, gjithnjë nën detyrimin për respektimin e detyrimeve pozitive të shtetit dhe të standardeve që burojnë nga instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare.

Në kontekst të kësaj të fundit, Aktgjykimi, ndër tjerash, shtjellon (i) parimet e përgjithshme të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për t'u zgjedhur dhe pjesëmarrjen; (ii) instrumentet dhe dokumentet e miratuara në nivel të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës që ndërlidhen me ndërmarrjen e

masave afirmative për përfaqësim të barabartë në politikë; (iii) përmbledhjet e rekomandimeve të Këshillit të Evropës dhe opinioneve e raporteve të Komisionit të Venecias ndërlidhur me kuotat gjinore në lista zgjedhore si masa të veçanta për të adresuar pabarazinë faktike në mes të gjinive në përfaqësim politik; dhe (iv) praktikën gjyqësore të Gjykatës, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatave Kushtetuese të shteteve tjera në lidhje me të drejtat zgjedhore dhe kuotat gjinore. Bazuar në dokumentet dhe parimet e shtjelluara në Aktgjykim, ky i fundit vë theks edhe në Rezolutën 1706(2010) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe e cila rekomandon që në vendet me sistem të listave me përfaqësim proporcional, duhet të merret parasysh futja e një kuote ligjore e cila parashikon jo vetëm një pjesë të lartë të kandidatëve gra dhe idealisht të paktën dyzet përqind (40%), por edhe një rregull të rreptë të renditjes së pozitive. Nga analiza e shtjelluar në Aktgjykim, rezulton që shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, përfshirë bazuar në Rekomandimin e Asamblesë Parlamentare, inkurajohen që të rrisin përfaqësimin e grave duke vendosur kuota gjinore, dhe të cilat, në parim, kanë dy karakteristika, përkatësisht (i) përcaktimin e një kuote minimale të përfaqësimit në lista zgjedhore të subjekteve politike; dhe (ii) një përcaktim të renditjes zinxhir të kandidatëve nga secila gjini ose nga një kandidat të secilës gjini, përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre (3) kandidatëve në rast të kuotës prej tridhjetë përqind (30%), me synimin që kandidatët e gjinisë më pak të përfaqësohen, të mos rrezikojnë që të vendosen shumë poshtë në listë dhe të kenë një mundësi reale për t'u zgjedhur. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, rezulton që shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe të cilat kanë vendosur mekanizma të tillë në ligjet përkatëse që rregullojnë përcaktimin e listave zgjedhore të subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, në parim, kanë përcaktuar lartësinë dhe/ose përqindjen e kuotës gjinore prej njëzet përqind (20%) deri në dyzet përqind (40%). Më tej dhe në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së dispozitës së kontestuar, Aktgjykimi së pari dhe ndërlidhur me përqindjen e kuotës gjinore në listat zgjedhore të subjekteve politike, vë theks në faktin që përderisa Kushtetuta mundëson vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë, ajo nuk përcakton përqindjen e kësaj kuote, duke i lënë hapësirën e nevojshme pushtetit legjislativ, përkatësisht Kuvendit të Republikës së Kosovës për të përcaktuar këtë përqindje, në përputhje me detyrimet pozitive të shtetit për të siguruar barazinë gjinore dhe e cila, pasi të jetë caktuar duhet të zbatohet me përpikëri. Aktgjykimi gjithashtu sqaron, që bazuar në praktikën gjyqësore të

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përcaktimi i kësaj kuote si masë e përkohshme dhe e nevojshme derisa të jetë arritur barazia gjinore, është çështje e politikës publike dhe e cila, i takon pushtetit legjislativ. Sipas sqarimeve të dhëna, nuk është në kompetencën e Gjykatës të përcaktojë lartësinë dhe/ose përqindjen e kësaj kuote ligjore, por Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka autorizimet e plota që të avancojë përqindjen e kuotës së lartcekur që ndërlidhet me përfaqësimin gjinor në listat e subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, gjithnjë në kontekst të një mase të nevojshme derisa të jetë arritur qëllimi i barazisë gjinore në Republikën e Kosovës dhe gjithnjë në pajtim me standardet e përcaktuara përmes mekanizmave të Këshillit të Evropës e të shtjelluara në këtë Aktgjykim. Së dyti, dhe ndërlidhur me qëllimin e synuar të përfaqësimit prej pesëdhjetë përqind (50%) të vendosur në Ligjin për Barazi Gjinore, Aktgjykimi i referohet praktikës së saj paraprake gjyqësore përmes të cilës është shtjelluar ky përcaktim, përfshirë Aktgjykimit të saj në rastin KI45/20 dhe KI46/20, me parashtruese Tinka Kurti dhe Drita Millaku dhe i cili, ndër tjerash, thekson që Kuvendi si ligjvënës nuk e ka formuluar përqindjen për pesëdhjetë përqind (50%) si një kuotë obligative ligjore por, e ka formuluar në formën e një asperate drejt arritjes së qëllimit dhe përcaktimit kushtetues për barazi gjinore në Republikën e Kosovës. Më saktësisht dhe sipas sqarimeve të dhëna, pesëdhjetë përqindëshi (50%) i synuar në Ligjin për Barazi Gjinore nuk është një kuotë ligjore për përfaqësim të detyrueshëm siç është tridhjetë përqindëshi (30%) i normuar në nenin 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Thënë këtë, që të dyja janë ligje të miratuara nga Kuvendi i Republikës dhe i takon këtij të fundit, që gradualisht të arrijë qëllimet që vet ka përcaktuar përmes procesit ligjvënës. Së treti, dhe ndërlidhur me standardin e nevojshëm të renditjes zinxhir të kandidatëve nga gjinitë përkatëse, Aktgjykimi thekson që neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, saktëson që lista e kandidatëve të secilit subjekt politik, duhet të përfshijë nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku një herë në secilin grup prej tre (3) kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë dhe që një rregullim i tillë, është i bazuar edhe në standardet e aplikueshme ndërkombëtare. Në fund, Aktgjykimi vë theks në faktin që Republika e Kosovës ka detyrimin kushtetues që të sigurojë barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore. Ashtu siç përcaktojnë dokumentet relevante të Këshillit të Evropës dhe të shtjelluara në Aktgjykim, mungesa e përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike, është një kërcënim për legjitimitetin e demokracive respektive.



**GJEDNJ – Vendime të rëndësishme
(1 korrik – 31 dhjetor 2024)**

*** Refuzimi i komunës Chişinău për t'i lejuar OJQ-së kundër diskriminimit të shfaqë afishen me karikatura, ka shkelur lirinë e saj të shprehjes (25/06/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Këshilli Kombëtar i Rinisë së Moldavisë kundër Republikës së Moldavisë** (kërkesa nr. 15379/13), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se: ka pasur **shkelje të nenit 10 (Liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me refuzimin e autoriteteve lokale për t'i lejuar OJQ-së parashtruese të shfaqë ilustrime kundër diskriminimit në panelet e reklamave, me arsyetimin se ato i paraqisnin disa grupe shoqërore në mënyrë të padenjë dhe poshtëruese. Gjykata vërejtë se afishja e OJQ-së parashtruese ishte pjesë e një fushate kundër diskriminimit që përfshinte edhe disa OJQ të tjera, një nga qëllimet e së cilës ishte promovimi i linjës së parë telefonike pa pagesë kundër diskriminimit në Moldavi. Çështja kryesore në këtë rast ishte vendimi i OJQ-së parashtruese për të ilustruar afishen e saj me karikatura.

Në këtë pikë, Gjykata përsëriti se satira është një formë e shprehjes artistike dhe e komentimit shoqëror që synon natyrshëm të provokojë dhe trazojë, duke kontribuar kështu në debatin publik. Karikaturat në afişe ishin shoqëruar me tekst që inkurajonte komunitetet përkatëse të telefononin një linjë telefonike pa pagesë nëse përjetonin diskriminim. Për Gjykatën ishte e qartë se qëllimi i synuar nuk kishte qenë të fyente, tallte apo stigmatizonte ato grupe të cënueshme të popullsisë apo të promovonte në mënyrë tinëzare gjuhën e urrejtjes dhe mosdurimin. Në kontekstin e drejtpërdrejtë dhe më të përgjithshëm, afishja dhe karikaturat kishin qenë qartësisht një mjet për të tërhequr vëmendjen e publikut pikërisht ndaj stereotipeve shoqërore dhe diskriminimit që e përjetojnë grupet e cënueshme, duke i inkurajuar ato të kërkojnë të drejtat e tyre. Gjykata vërejtë më tej se gjykatat vendore nuk kishin kryer një shqyrtim efektiv siç kërkohet nga neni 10 i Konventës. Sipas Gjykatës, ky dështim ishte faktor kyç në konstatimin se nuk kishte pasur arsye relevante dhe të mjaftueshme për ndërhyrjen në të drejtën e OJQ-së parashtruese për lirinë e shprehjes. Për më tepër, një ndërhyrje e tillë mund të ketë efekt frikësues ndaj formave satirike të shprehjes lidhur me çështjet shoqërore. Prandaj, ndërhyrja nuk kishte qenë e nevojshme në një shoqëri

*** Kriminalizimi i blerjes së akteve seksuale (Ligji nr. 2016-444): nuk ka shkelje të nenit 8 të Konventës (25/07/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin M.A. dhe të tjerët kundër Francës (kërkesat nr. 63664/19, 64450/19, 24387/20, 24391/20 dhe 24393/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se: nuk ka pasur shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte, sipas ligjit penal francez, me krijimin e veprës penale të blerjes së marrëdhënieve seksuale që, sipas pretendimeve të parashtruesve, rrezikonte seriozisht integritetin fizik dhe mendor si dhe shëndetin e personave që merren me prostitucion, dhe cenonte në mënyrë radikale të drejtën e tyre për respektimin e jetës private, për aq sa kjo përfshin të drejtën për autonomi personale dhe liri seksuale.

Gjykata vërejtë se problemet e lidhura me prostitucionin ngrenë çështje shumë të ndjeshme morale dhe etike, që sjellin mendime të ndryshme, shpesh kontradiktore, dhe se ende nuk ka një konsensus të përgjithshëm ndërmjet shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, apo edhe brenda organizatave të ndryshme ndërkombëtare që trajtojnë këtë çështje, mbi mënyrën më të mirë për t'iu qasur prostitucionit. Gjykata më pas konstatoi se kriminalizimi i përgjithshëm dhe absolut i blerjes së akteve seksuale si mjet për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore është aktualisht objekt i debateve të ashpra që shfaqin dallime të mëdha mendimesh si në nivel evropian ashtu edhe në atë ndërkombëtar, pa nxjerrë një qëndrim të qartë.

Gjykata konstatoi se autoritetet franceze nuk e kanë tejkaluar diskrecionin e tyre (“shkallën e vlerësimit”) në miratimin e ndalimit të kontestuar, për aq sa ai rezultoi nga një ekuilibër i arritur përmes një procesi demokratik brenda shoqërisë në fjalë dhe bën pjesë në një qasje gjithëpërfshirëse – të parashikuar me Ligjin nr. 2016-444 e 13 prillit 2016 – në të cilin janë marrë parasysh shqetësimet e ndryshme të ngritura nga parashtruesit e kërkesës në këtë rast. Megjithatë, Gjykata theksoi se autoritetet kombëtare kanë detyrimin të mbajnë nën shqyrtim të vazhdueshëm qasjen e miratuar prej tyre, veçanërisht kur ajo bazohet në një ndalim të përgjithshëm dhe absolut të blerjes së akteve seksuale, në mënyrë që të jetë në gjendje ta ndryshojë atë me evoluimin e shoqërive evropiane dhe standardeve ndërkombëtare në këtë fushë, dhe ta përshtatin me efektet konkrete të zbatimit të këtij legjislacioni.



*** Anëtarësimi në Partinë Komuniste Sovjetike si bazë legjitime për të ndaluar kandidimin për Parlamentin Letonez (25/07/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Ždanoka kundër Letonisë (nr. 2)** (kërkesa nr. 42221/18), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se: **nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 (E drejta për zgjedhje të lira)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me heqjen e znj. Ždanoka, një ish-deputete e Parlamentit Evropian, nga lista e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare të vitit 2018, për shkak të anëtarësit të saj aktiv në Partinë Komuniste të Letonisë gjatë konfliktit të periudhës së pas-pavarësisë kundër Bashkimit Sovjetik. Ajo kishte qenë kandidatë për Unionin Letonez të Rusëve. Gjykata konstatoi në veçanti se kufizimi i individëve që kanë rrezikuar dhe vazhdojnë të rrezikojnë pavarësinë e shtetit letonez dhe parimet e një shteti demokratik që qeveriset nga sundimi i ligjit nga kandidimi në zgjedhje është legjitim dhe proporcional. Prandaj, autoritetet kanë vepruar në kuadër të diskrecionit të tyre (“shkalla e vlerësimit”) në rastin e znj. Ždanoka.

*** Mungesa e garancive të mjaftueshme kundër paanshmërisë së gjyqtarit në rastet që kanë të bëjnë me shkarkimet nga puna nga kompania gjeorgjiane e energjisë elektrike Telasi (29/08/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Tsulukidze dhe Rusulashvili kundër Gjeorgjisë** (kërkesat nr. 44681/21 dhe 17256/22), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se: ka pasur **shkelje të nenit 6 § 1 (E drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me pretendimet për mungesën e paanshmërisë së një gjyqtari të Gjykatës Supreme, i cili ishte anëtar i kolegjit prej tre gjyqtarësh që refuzoi pretendimet e ngritura nga parashtruesit, asistentja gjyqësore e të cilit ishte vajza e avokatit të palës së paditur, kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike Telasi, në atë procedurë. Gjykata konstatoi në veçanti se fakti që asistentja gjyqësore e gjyqtarit ishte vajza e përfaqësuesit juridik të Telasi-t, së bashku me mandatin e gjerë që iu është dhënë asistentëve gjyqësorë në sistemin gjyqësor gjeorgjian, kishte krijuar një situatë e cila në mënyrë legjitime mund të ngjallte dyshime mbi paanshmërinë e gjyqtarit L.M. Parashtruesit nuk kishin dijeni se deri në çfarë mase asistentja gjyqësore ishte e përfshirë realisht në rastet e tyre, dhe Gjykata Supreme kishte dështuar të sqarojë rrethanat e përfshirjes së saj, duke mos arritur kështu

të largojë dyshimet e tyre lidhur me paanshmërinë e atij gjyqtari. Prandaj, Gjykata konstatoi se dyshimet e tyre ishin të justifikuar në mënyrë .

*** Procedurat penale kundër një ish-deputeti të Parlamentit Evropian pas publikimit të një artikulli në “The Sunday Times” nuk ishin të padrejta (08/10/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Severin kundër Rumanisë** (kërkesa nr. 20440/18), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se: **nuk ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) (E drejta për një proces të rregullt/E drejta për të marrë në pyetje dëshmitarët)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me drejtësinë e procedurave penale kundër z. Severin në lidhje me pretendimin për marrje ryshfeti gjatë kohës sa ai ishte anëtar i Parlamentit Evropian (DPE). Procedurat, të cilat rezultuan me dënim me burg prej katër vjetësh, ishin iniciuar pas publikimit të një artikulli nga dy gazetarë britanikë të “The Sunday Times”, të cilët ishin paraqitur si lobistë dhe i kishin ofruar parashtruesit para në këmbim të mbështetjes së tij për disa ndryshime legjislative të paraqitura në Parlamentin Evropian.

Para Gjykatës Evropiane, parashtruesi argumentoi se dy gazetarët kishin vepruar si agjentë provokatorë. Ai gjithashtu u ankua për përdorimin nga gjykatat rumune të incizimeve të gazetarëve dhe faktin që gazetarët ishin marrë në pyetje në rrethana që ai pretendonte se kishin qenë të pafavorshme për mbrojtjen e tij. Lidhur me pretendimin se gazetarët britanikë kishin vepruar si agjentë provokatorë, Gjykata vërejti se nuk kishte prova të përfshirjes së shtetit në rastin konkret dhe se dy gazetarët kishin vepruar gjatë gjithë kohës si persona privatë. Sa i përket procedurave penale në tërësi, Gjykata konsideroi se ato i kishin ofruar parashtruesit garanci të mjaftueshme për ushtrimin e të drejtave të tij të mbrojtjes.

Duke marrë parasysh peshën e mundshme të provave të marra ose të ofruara nga gazetarët – veçanërisht incizimeve – dhe vështirësitë që mund të kishte krijuar për mbrojtjen përdorimi i tyre, Gjykata vërejti se parashtruesi kishte pasur mundësinë të paraqiste argumentet e tij para gjykatave vendore, ku ato ishin shqyrtuar në një mënyrë që është në përputhje me dispozitat e nenit 6 të Konventës. Gjykata gjithashtu konsideroi se mënyra se si dëshmitarët ishin marrë në pyetje gjatë procedurave ishte në përputhje me atë dispozitë dhe i kishte mundësuar parashtruesit të kërkesës të ushtronte në mënyrë efektive të drejtat e tij.



*** Ndalimi i demonstratës sindikale në kulmin e pandemisë Covid ishte i justifikuar (17/10/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Central Unitaria de Traballadores/as kundër Spanjës** (kërkesa nr. 49363/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi, me 6 vota për dhe 1 kundër, se: **nuk ka pasur shkelje të nenit 11 (Liria e tubimit dhe organizimit)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me refuzimin e autoriteteve lokale në Galicia për t'i lejuar një sindikate organizimin e një demonstrate në formë autokolone në Vigo me rastin e Ditës së Punëtorëve, për shkak të kufizimeve të Covid-it që ishin në fuqi në atë kohë. Gjykata vërejt rrethanat e vështira në të cilat autoritetet spanjolle ishte dashur të marrin vendimet e tyre – në fillim të një pandemie, pa njohuri të plota mbi origjinën dhe incidencën e sëmundjes dhe me presion të madh mbi sistemin shëndetësor. Gjykata konstatoi në veçanti se autoritetet spanjolle kishin balancuar nevojën për të mbrojtur shëndetin publik me të drejtat e sindikatës, dhe se ndalimi kishte qenë i justifikuar në këtë kontekst.

*** Legjislacioni për “agjentët e huaj” në Rusi është arbitrar dhe krijon një klimë mosbesimi (22/10/2024)**

Rasti **Kobaliya dhe të tjerët kundër Ruisë** (kërkesa nr. 39446/16 dhe 106 të tjera) kishte të bënte me kornizën legjislative në zhvillim e sipër në Rusi që kërkonte nga shumë OJQ, organizata mediatike dhe individë të regjistroheshin si “agjentë të huaj”, dhe pasojat që kjo kishte në aktivitetet dhe jetën e tyre private. Në aktgjykimin e Dhomës së saj në këtë rast, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se: ka pasur **shkelje të neneve 10 (Liria e shprehjes) dhe 11 (Liria e tubimit)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të gjithë parashtruesit, dhe **shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** për parashtruesit individualë. Gjykata konstatoi se legjislacioni aktual i zabtueshëm ishte stigmatizues, çorientues dhe përdorej në mënyrë tepër të gjerë dhe të paparashikueshme. Kjo e çoi Gjykatën në përfundimin se qëllimi i legjislacionit ishte të ndëshkonte dhe frikësonte, në vend që të adresonte çfarëdo nevojë të pretenduar për transparencë apo shqetësime legjitime lidhur me sigurinë kombëtare. Gjykata përmendi në veçanti detyrimin për organizatat dhe individët e caktuar që të etiketojnë çdo publikim të tyre me një njoftim ku shpallej statusi i tyre si “agjentë të huaj”, përjashtimin e tyre nga të gjitha proceset zgjedhore,

kufizimet në profesionet e mësimdhënies, mohimin e qasjes te audiencat e reja dhe privimin nga të ardhurat që vijnë nga reklamuesit privatë, si dhe sanksionet qartazi joproportionale – përfshirë gjobat arbitrare dhe madje edhe shpërbërjen. Këto kufizime kishin një ndikim frikësues në diskursin publik dhe në angazhimin qytetar. Ato krijonin një klimë dyshimi dhe mosbesimi ndaj zërave të pavarur dhe dobësonin vetë themelet e një shoqërie demokratike. Gjykata konstatoi se korniza legjislative ishte bërë dukshëm më kufizuese që nga viti 2012, duke ndikuar në një numër shumë më të madh të OJQ-ve, organizatave mediatike dhe individëve dhe duke u larguar edhe më tej nga standardet e Konventës.

*** Trajtimi nga autoritetet i publikimit të pamjeve intime në internet pa pëlqim ishte i papërshtatshëm (03/12/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **M.Ş.D. kundër Rumanisë** (kërkesa nr. 28935/21), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi njëzëri se: ka pasur **shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me ngjarjet pas prishjes së një marrëdhënieje në vitin 2016, kur M.Ş.D. ishte 18 vjeç. Ish i dashuri i saj, V.C.A., ndër të tjera, u kishte dërguar fotografi intime të saj anëtarëve të familjes dhe të tjerëve, dhe i kishte postuar ato, së bashku me të dhënat e saj personale, në faqet e internetit për eskortë. Parashtruesja e kërkesës u ankua menjëherë te autoritetet për veprimet e V.C.A., por hetimi penal dhe procedurat gjyqësore përkatëse mbetën pezull për një kohë të gjatë, deri sa u arrit edhe afati i parashkrimit për përgjegjësinë penale. Shumica e akuzave kundër V.C.A., në fund, u hodhën poshtë. Gjykata konstatoi në veçanti se korniza ligjore kishte qenë e papërshtatshme – duke dështuar ta mbronte M.Ş.D. nga dhuna në internet – dhe se hetimi i pretendimeve të saj kishte qenë joefektiv, për shkak të vonësive të tejzgjatura, sjelljes së autoriteteve që ia atribuonin pjesërisht fajin M.Ş.D., duke kontribuar kështu në “riviktimizimin” e saj, si dhe refuzimit të shprehur të zyrës së prokurorit për të zbatuar urdhrat e gjykatës.

*** Dënimi i drejtorit të botimit të revistës “Le Point” dhe dy gazetarëve për shpifje në artikullin me titull “Afera Copé” nuk ka cenuar lirinë e tyre të shprehjes (05/12/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Giesbert dhe të tjerët kundër Francës** (kërkesa nr. 835/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi njëzëri se: **nuk ka pasur shkelje të nenit 10 (Liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të



Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me dënimin e parashtruesve të kërkesës – drejtorit të botimit të revistës “Le Point” dhe dy gazetarëve që punonin për atë revistë javore – për shpifje si rezultat i publikimit, më 27 shkurt 2014, të një artikulli të titulluar “Afera Copé” lidhur me kompaninë Bygmalion dhe lidhjet e saj me partinë politike UMP dhe me udhëheqësin e saj të atëhershëm z. Jean-François Copé. Parashtruesit pretendonin se dënimi i tyre për shpifje publike binte ndesh me nenin 10 të Konventës, i cili mbron lirinë e shprehjes. Gjykata nuk pa asnjë arsye serioze për të vënë në dyshim vlerësimin unanim të bërë nga gjykatat vendore në rastin konkret. Në veçanti, Gjykata konsideroi se atyre mund t’u ishte dukur e arsyeshme se parashtruesit nuk kishin ushtruar kujdesin e duhur dhe të nevojshëm gjatë verifikimit të saktësisë së fakteve të pretenduara dhe se artikulli fyes, i cili e kishte paraqitur informacionin dhe materialin e raportuar në të si “Afera Copé”, kishte qenë produkt i një vendimi të qëllimshëm redaksional që nuk kishte bazë të mjaftueshme në fakte. Duke marrë parasysh se sanksioni i shqiptuar ndaj parashtruesve – një gjobë penale – nuk kishte qenë disproporcional në raport me qëllimin legjitim të ndjekur, Gjykata konkludoi që, pa tejkalluar shkallën e tyre të vlerësimit, gjykatat vendore – gjetjet e të cilave ishin bazuar në arsye relevante dhe të mjaftueshme – kishin pasur arsye për të vlerësuar se ndërhyrja në të drejtën e parashtruesve për liri të shprehjes ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, për të mbrojtur “reputacionin ose të drejtat e të tjerëve”.

*** Çështja strukturore e dukshme në Shqipëri lidhur me regjistrimin e pronës (10/12/2024)**

Rasti **Ramaj kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 17758/06) kishte të bënte me një parcelë toke prej 6,700 m² në zonën “Uji i Ftohtë”, e cila ishte konfiskuar nga regjimi komunist. Një aktgjykim i vitit 2004 që i kthente pronësinë z. Ramaj nuk ishte zbatuar asnjëherë, ndërsa autoritetet kanë refuzuar në mënyrë të përsëritur kërkesat e tij për ta regjistruar pronësinë e tij. Në aktgjykimin e Dhomës së saj në këtë rast, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se **nuk kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa i përket pjesës së parcelës së tokës e cila ishte zënë nga ndërtesa të paligjshme. Ato pjesë të veçanta të tokës në fakt ishin shpronësuar dhe z. Ramaj mund të kishte aplikuar për kompensim, gjë që duket se nuk e kishte bërë. Megjithatë, Gjykata vendosi, njëzëri, se kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës sa i përket pjesës së mbetur të parcelës së tokës. Gjykata konstatoi në veçanti se mënyra e

trajtimit të situatës së z. Ramaj nga autoritetet kishte mungesë qartësie dhe transparence. Ndërhyrja e ekzekutivit në titujt e pronës, hartat e pasakta të regjistrimit të tokës, mungesa e procedurave të qarta në rastet e titujve të mbivendosur dhe mospërputhjet në praktikën ligjore vendore sa i përket respektimit të regjistrimit të urdhëruar nga gjykata kishin kontribuar që të gjitha në lënien e z. Ramaj në një gjendje pasigurie përkitazi me pronën e tij për më shumë se 26 vjet. Çështjet që kishin çuar në moszbatimin e aktgjykimit përfundimtar në favor të z. Ramaj duket se shkonin përtej këtij rasti specifik dhe ishin pjesë e një konteksti sfidues të ngjarjeve historike komplekse. Gjykata këshilloi autoritetet kombëtare të vendosin procedura efikase dhe transparente dhe një sistem funksional të regjistrimit të pronës së paluajtshme në mënyrë që të sigurojnë respektimin e të drejtave të pronarëve.

*** Ndalimi i kontaktit ndërmjet fëmijëve dhe nënës së tyre në rastin e kujdestarisë dhe të drejtave të kontaktit në Slloveni ishte i paarsyeshëm (19/12/2024)**

Rasti **X dhe të tjerët kundër Sllovenisë** (kërkesat nr. 27746/22 dhe 28291/22) kishte të bënte me vendimet për kujdestarinë dhe të drejtat e kontaktit pas ndarjes së X nga babai i fëmijëve të saj në vitin 2018. Gjithashtu, rasti kishte të bënte me ricaktimin e rastit gjyqësor të X te një gjyqtar i caktuar. Në aktgjykimin e Dhomës së saj në këtë rast, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se: kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 1 (E drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën e X që rasti i saj të shqyrtohet nga një gjykatë e themeluar me ligj, dhe **shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** në lidhje me:

- fëmijët parashtrues, përkitazi me urdhrin për t’i larguar ata nga kujdesi i X (nënës së tyre) në mars të vitit 2020, mospërfaqësimi i tyre në procedurat për kontakt dhe kujdestari, dhe moslejimi i kontaktit me nënën e tyre;

- X, për moslejimin e kontaktit me fëmijët e saj.

Gjykata konstatoi në veçanti se Kryetari i Gjykatës së Qarkut, duke ia caktuar rastin e parashtruesve një gjyqtari të caktuar, në kundërshtim me kriteret objektive të paracaktuara, kishte sfiduar qëllimin e qartë të ligjit – përkatësisht, të sigurojë rastësinë në caktimin e rasteve. Gjithashtu, Gjykata vlerësoi se dy urdhra të përkohshëm dhe një aktgjykim që ndalonte kontaktin ndërmjet fëmijëve dhe nënës së tyre nuk ishin të arsyetuara dhe se largimi i fëmijëve nga X nuk ishte mbështetur me arsye relevante dhe të



mjaftueshme. Për më tepër, dështimi i gjykatave vendore për të siguruar përfaqësim të duhur të interesave të fëmijëve gjatë procedurave për kontakt dhe kujdestari përbënte në vetvete shkelje të së drejtës së fëmijëve për respektimin e jetës së tyre familjare.

*** Hetimi parlamentar lidhur me infiltrimin e mafias në lozhat masonike: kontroll dhe sekuestrim në kundërshtim me Konventën (19/12/2024)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Grande Oriente d'Italia kundër Italisë** (kërkesa nr. 29550/17), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se: kishte pasur **shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me një kontroll në ambientet e një shoqate masonike të urdhëruar në kontekstin e një hetimi parlamentar mbi mafian. Gjatë kontrollit ishin sekuestruar dokumente në letër dhe në formë digjitale, në veçanti një listë me emrat dhe të dhënat personale të më shumë se 6,000 anëtarëve të shoqatës. Gjykata konstatoi se kishte mungesë të provave ose dyshimit të bazuar për përfshirje në çështjen që po hetohej, të cilat do të ishin të mjaftueshme për të arsyetuar një masë kaq të gjerë dhe të papërcaktuar. Për më tepër, mangësitë në urdhrin për kontroll nuk ishin kompensuar nga garanci të mjaftueshme ekuilibruese, si për shembull një shqyrtim i pavarur dhe i paanshëm. Në fakt, sipas sistemit aktual në Itali, Parlamenti ka juridiksion ekskluziv për të vendosur për vlefshmërinë e vendimeve të tij. Gjykata konkludoi se një ndërhyrje kaq e rëndësishme në të drejtat e shoqatës parashtruese, që përfshinte shqyrtimin dhe mbajtjen e një game të gjerë të dokumenteve nga ana e gjykatës, përfshirë informata konfidenciale, nuk ishte “e parashikuar nga ligji”, e as nuk ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

(Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: www.echr.coe.int)

INFORMATA PËR GJYKATËN

Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuar në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.

Objekti i Gjykatës ka gjithsej 1 937 m² hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.



ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10 000 - Prishtinë

Tel: +383 (0)38 60 61 62

Mob: +383 (0)45 200 595; +383 (0)45 200 576

Fax: +383 (0)38 60 61 70

E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org

Ueb: www.gjk-ks.org